

1 E mërkurë, 12 shkurt 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 11.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]. Ju lutem  
6 paraqisni lëndën, znj. Sekretare.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar  
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i  
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep  
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej për  
12 procesverbal që të katër të akuzuarit janë të pranishëm në  
13 sallë.

14 Sot do punojmë deri në orën 12.00, pastaj do bëjmë një  
15 pushim prej dhjetë minutash deri në orën 1.00, pastaj do bëjmë  
16 seancën e pushimit të drekës si zakonisht dhe pasditen do ta  
17 bëjmë si çdo ditë tjetër.

18 Sot do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit të  
19 Prokurorisë 04290.

20 Ka një çështje paraprake që dua të shqyrtoj përpara se të  
21 fillojmë me dëshminë e këtij dëshmitari.

22 Dje, Trupi Gjykses përcaktoi si numër MFI për provën  
23 P02037. Pasi mori parasysh konstatimet edhe parashtrimet e  
24 palëve, Trupi Gjykses konstaton se dokumenti me numër MFI  
25 P02037 i përmbush kërkesat *prima facie* sipas rregullës 138.

1 Në veçanti, Trupi Gjykues vëren se ZPS-ja ka kërkuar që  
2 të pranohet ky dokument pasi janë treguar disa faqe të këtij  
3 dokumenti Dëshmitarit 04290. Dëshmitari konfirmoi që shkrimi i  
4 dorës ishte i tij në disa prej faqeve dhe dha gjithashtu  
5 dëshmi të tjera lidhur me këto faqe, përfshirë këtu edhe  
6 dëshmitarin që ka kërkuar organizimin e mbledhjes së armëve.

7 Trupi Gjykues për pasojë bindet se dokumenti që  
8 aktualisht ka numër provizor prove P02037 është relevant,  
9 është autentik *prima facie* dhe ka vlerë provuese.

10 Duke marrë parasysh faktin që Mbrojtja ka ose do të jetë  
11 në gjendje që të marrë në pyetje dëshmitarin dhe sigurisht që  
12 mund ta pyes atë lidhur me këtë dokument, Trupi Gjykues  
13 gjithashtu është i bindur që vlera provuese e dokumentit që  
14 aktualisht ka numër provizor P02037 zhbëhet nga efekti  
15 paragjykues.

16 Duke marrë parasysh sa më sipër, Trupi Gjykues e pranon  
17 në prova gjyqësore dokumentin P02037 dhe udhëzon NJAGJ-në që  
18 ta shtojë atë në provën P01644.

19 Ky përfundon urdhrin gojor të Trupit Gjykues.

20 Tani mund të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit 4290.

21 Znj. Sekretare, ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, sa për sqarim  
23 përpara sesa të vijë dëshmitari. Sa i takon numrit të provës  
24 që tani e ka marrë numrin e provës P1644, dy faqe janë pranuar  
25 si provë P220. Thjesht do kërkonim që faqet e tjera të

1 shtoheshin në provën ekzistuese.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta bëjmë  
3 këtë gjë.

4 Besoj se po, apo jo, Sekretare?

5 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës  
6 këshillohen]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
8 Atëherë mund ta përdorim për prova të tjera provën P02037 dhe  
9 dokumentin që sapo e diskutuam mund t'ia shtojmë provës që e  
10 citoi Prokurori pak më herët.

11 [Dëshmitari vijon dëshminë]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,  
13 Dëshmitar.

14 Për procesverbal vërej që, z. Qerkini, Avokati Kujdestar  
15 është i pranishëm këtu siç ka qenë edhe gjatë ditëve të tjera  
16 të dëshmisë së këtij dëshmitari.

17 Dëshmitar, mirëmëngjes.

18 DËSHMITARI: Mirëmëngjes.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Selimi, ne  
20 do të vazhdojmë me dëshminë tuaj sot. Ju kujtoj që t'i  
21 përgjigjeni pyetjeve qartë, me fjali të shkurtër. Në qoftë se  
22 nuk e kuptoni një pyetje të caktuar, lirisht mund t'i kërkonte  
23 avokatit përkatës që ta përsërisë pyetjen ose t'i thoni që nuk  
24 e kuptoni pyetjen dhe ata do të bëjnë sqarimet përkatëse. Po  
25 ashtu, duhet që të jepni bazën e njohurive, fakteve dhe

1 rrethanave për të cilat do t'ju pyesin palët.

2 Ju kujtoj që jeni ende nën detyrimin për të thënë të  
3 vërtetën dëshmitar sikurse e keni deklaruar në betimin solemn.  
4 Gjithashtu ju kujtoj që garancitë e dhëna prej Trupit Gjykues,  
5 përkatësisht që përgjigjet që do jepen prej jush ndaj pyetjeve  
6 që do t'ju bëhen nuk do të përdoren në procedimet penale para  
7 Dhomave të Specializuara, me përjashtim të parashikimeve të  
8 dhëna në nenin 15(2) i Ligjit dhe rregullës 65 të cilat janë  
9 ende të zbatueshme. Refuzimi për të dhënë dëshmi mund të  
10 sanksionohet me vënien e një gjobe.

11 Ju lutem flisni pranë mikrofonit, bëni një pauzë prej  
12 pesë sekondash përpara sesa t'i përgjigjeni pyetjes dhe flisni  
13 ngadalë në mënyrë të tillë që t'ju kapin përkthyesit.

14 Nëse e shihni që keni të nevojshme për të bërë një  
15 pushim, ju lutem na e thoni këtë gjë dhe ne do të mundohemi që  
16 të bëjmë organizimet përkatëse.

17 Për informimin tuaj, tani do vazhdojmë seancën deri në  
18 orën 12.00, në orën 12 do bëjmë një pushim prej dhjetë  
19 minutash, do vazhdojmë në orën 12.10 deri në orën 1.00, pastaj  
20 nga ora 1.00 deri në 2.30 do bëjmë pushimin e drekës dhe nga  
21 2.30 deri në 4.30 do vazhdojmë si rregullisht.

22 A jeni gati për të vijuar, Dëshmitar?

23 DËSHMITARI: Po, i nderuar, fillojmë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

25 Vazhdojmë me pyetjet e z. Dixon për dëshmitarin, Mbrojtja

1 e z. Veseli.

2 Z. Dixon, fjala për ju.

3 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

4 DËSHMITARI: SYLEJMAN SELIMI [Vijon]

5 Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon: [Vazhdim]

6 Z. DIXON: [Përkthim]

7 PY. Mirëmëngjes, z. Selimi.

8 PË. Mirëmëngjes.

9 PY. Do filloj aty ku e lamë dje, ku po na përshkruanit  
10 vrasjen e shokut tuaj z. Kiqina, ndërkohë që ai po udhëtonte  
11 nga Drenica për në Pashtrik. A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

12 PË. Po, i nderum.

13 PY. Atëherë sa për të folur për datën se ju përmendët se  
14 ishte viti 1999, por a ka qenë kjo pak a shumë nga fundi i  
15 majit të vitit 1999, e konfirmoni këtë, Dëshmitar?

16 PË. Po, e saktë.

17 PY. A është po ashtu e drejtë të thuhet se zona në të cilën  
18 është vlarë ai ka qenë në një rrugë që është një magjistrale,  
19 një rrugë kryesore që është në pjesën e kufirit jugor të zonës  
20 së Drenicës nga ku të duhet të kalosh në mënyrë të tillë që të  
21 shkosh në Pashtrik, a është përshkrimi i duhur ky?

22 PË. Po, e saktë.

23 PY. Magjistrale është ajo që shkon nga Prishtina në Pejë,  
24 pra, duke kaluar nga lindja në perëndim dhe është kufiri midis  
25 dy zonave Drenicës dhe Pashtrikut, a është kështu, është e

1 saktë kjo, Dëshmitar?

2 PË. Po, e saktë.

3 PY. Gjatë luftës, e kam fjalën këtu edhe për vitin 1998 dhe  
4 1999 kur z. Kiqina u vra, ajo rrugë është përdorur ose është  
5 kontrolluar në pjesën dërrmuese nga forcat serbe, a është e  
6 saktë kjo?

7 PË. Po, e saktë.

8 PY. Ishte një rrugë shumë e vështirë dhe e rrezikshme për t'u  
9 kaluar nga zona e Drenicës nga ku ju keni qenë komandant i  
10 zonës, domethënë, ishte rrugë e vështirë për juve për t'u  
11 bërë, domethënë, për të kaluar nga Drenica për në Pashtrik, a  
12 është e saktë kjo?

13 PË. Po, e saktë.

14 PY. Kjo ishte situata edhe kur ju u bëtë komandant i  
15 përgjithshëm i UÇK-së dhe kur lëvizët dhe shkuat në Shtabin e  
16 Përgjithshëm në zonën e Pashtrikut edhe në atë kohë ishte e  
17 vështirë që të kalohej nga Drenica në Pashtrik, ose nga  
18 Pashtriku të shkohej në Drenicë për shkak të rrezikshmërisë që  
19 paraqiste një rrugë e tillë e cila ishte e kontrolluar  
20 vazhdimisht nga forcat serbe, a është e saktë kjo?

21 PË. Po, e saktë.

22 PY. Faleminderit. Tani dua t'ju pyes lidhur me diçka që thatë  
23 dje në dëshminë tuaj - për procesverbal këtë e thatë në faqen  
24 102 dhe 103. Ju thatë se z. Jashari ishte komandant i policisë  
25 ushtarake dhe iu ka raportuar juve si komandant zone dhe ka

1 shërbyer nën urdhrat tuaja, po ashtu ju thatë që z. Jashari ka  
2 vazhduar që të raportonte gjatë gjithë kohës që unë kam qenë  
3 komandant zone dhe ka qenë nën urdhrin tim. A ju kujtohet ta  
4 keni thënë këtë?

5 PË. Po, e saktë.

6 PY. Mbështetur në këtë, është e drejtë të thuhet, apo jo, që  
7 z. Kiqina në rolin e tij si oficer zbulim-kundërzbulimi nuk  
8 mund t'i jepte urdhra z. Jashari nga policia ushtarake apo nuk  
9 mund -- ose e thënë ndryshe, domethënë, urdhrat që i jepeshin  
10 policisë ushtarake ishin thjesht urdhra që i jepnit ju, nuk  
11 mund t'i jepte dikush tjetër, a është e saktë kjo?

12 PË. Po, e saktë.

13 PY. Tani le të kalojmë në fund të vitit 1998 dhe do të  
14 vazhdojmë në vitin 1999 më tej. Në këtë kohë a ju kujtohet që  
15 ta keni ditur që z. Kadri Veseli ka qenë jashtë shteti, pra,  
16 nuk ka qenë në Kosovë në fund të vitit 1998 dhe pastaj në  
17 vijim të 1999? Më pas do ju bëj pyetje kur jeni takuar, kur e  
18 keni parë në fund të marsit, po përpara kësaj periudhe,  
19 domethënë, përpara marsit, besoj që ju e dini që z. Veseli nuk  
20 ka qenë në Kosovë, a është e saktë, Dëshmitar?

21 PË. Është e saktë që unë nuk e kam taku asnjëherë dhe nuk e  
22 di ku ka qenë.

23 PY. Pra, ju nuk keni pas kontakt me të gjatë kësaj periudhe  
24 deri nga fundi i marsit i 1999 kur e keni parë në zonën e  
25 Nerodimës. A është e saktë kjo?

1 PË. Në e ke fjalën për 1999 apo për 1998?

2 PË. E kam fjalën për 1999. Ju kërktoj ndjesë në qoftë se nuk  
3 isha i qartë. E kam fjalën për janarin, shkurtin, marsin e  
4 1999-s, domethënë, në këtë periudhë ju nuk është se keni pasur  
5 kontakt me të deri në momentin kur e keni parë në zonën e  
6 Nerodimës në fund të marsit të 1999-s, a është e saktë kjo,  
7 Dëshmitar?

8 PË. Nuk e di. Më duket që e kam pa, po kontakt kështu s'kam  
9 pas direkt me të asnjëherë. Më duket se një herë jemi taku në  
10 një fshat afër Drenicës, dikun nga fundi i shtatorit apo, ose  
11 fillimi i nëntorit. S'po di. Nuk e di saktë, po e di që para  
12 Nerodimës më duket që jemi taku.

13 PY. Atëherë kur këtu thoni fundi i shtatorit apo i nëntorit,  
14 besoj se e keni fjalën për 1998, apo jo? Domethënë, thoni  
15 mbase mund ta keni parë nga fundi i shtatorit ose i nëntorit i  
16 1998, a është e saktë kjo, Dëshmitar, për këtë e keni fjalën?

17 PË. Nuk jam i sigurtë. Më duket që pas, a s'e di a ka qenë  
18 ofensiva në 1998 apo fillimi i 1999 kur me disa të plagosun më  
19 duket që jemi taku para Nerodimës. Nuk jam i sigurtë.

20 PY. Në rregull. Atëherë ta përcaktojmë më saktë kohën, ju  
21 sigurisht që e keni takuar atë nga fundi i marsit në zonën e  
22 Nerodimës në vitin 1999 dhe ju thoni që besoni që e keni parë  
23 atë edhe një herë më përpara sesa ta takonit që mund të ketë  
24 qenë mbase nga shtatori ose nëntori i 1998. A e thatë kështu?  
25 Është përshkrim i saktë, është përmbledhje e saktë e asaj



1 çfarë thatë, Dëshmitar?

2 PË. Po, është e saktë.

3 PY. Në shkurt të vitit 1999, dje ju treguan disa

4 procesverbale të takimeve të Shtabit të Përgjithshëm.

5 Domethënë, bëhej fjalë për fillimit e shkurtit ose më saktë në

6 6 shkurt 1999. Ju thatë që ju kujtohet që keni marrë pjesë në

7 mbledhje të tilla. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

8 PË. Po, e saktë.

9 PY. Ka qenë një takim me disa prej anëtarëve të Shtabit të

10 Përgjithshëm dhe me komandantët e zonave. Kështu ju kujtohet,

11 kështu ka qenë?

12 PË. Nuk e di datën, po e saktë. Ne e kemi pas një takim

13 bashkë me komandantët e zonave.

14 PY. Në rregull. Kjo ka ndodhur më përpara në kohë, domethënë,

15 përpara sesa të bëheshit komandant i përgjithshëm i UÇK-së, e

16 saktë?

17 PË. Po, e saktë.

18 Z. DIXON: [Përkthim] I lutem Sekretares të paraqesë në

19 ekran provën P182.

20 PY. Për kontekst, Dëshmitar, bëhet fjalë për një kopje të të

21 njëjtave procesverbale të cilat ju i patë edhe dje, do t'ju

22 pyes lidhur me një pjesë të këtij procesverbali.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Më konkretisht pjesa për të cilën

24 jam interesuar është në faqen 226401. Do ta shikojmë këtë

25 material në të dyja versionet në shqip dhe në anglisht. Të

1 kalojmë një faqe më përpara që të shohim se kush e ka thënë  
2 këtë. Është Rrustem Mustafa. Ndoshta dy faqe më përpara.

3 PY. A e shikoni Remin në fillim të faqes?

4 PË. Po.

5 PY. Domethënë, Remi pretendohet që të jetë personi që i ka  
6 thënë përmbajtjen më pas dhe në qoftë se do kalojmë dy faqe më  
7 tej në dokument thuhet:

8 "Sigurimi (SHI) nuk mund të sigurojë ushtrinë nga jashtë.

9 "Kam mendimin që duhet të caktohet një komandant, si  
10 komandant një profesionist i cili duhet -- të cilin ne duhet  
11 të kemi mundësi ta mbajmë nën kontroll."

12 A ju kujtohet ta ketë thënë Remi këtë lidhur me shërbimin  
13 informativ, me zbulim-kundërzbulimin? Ju kujtohet ta ketë  
14 thënë Remi këtë?

15 PË. Jo, nuk më kujtohet.

16 PY. A ju kujtohet kjo - pra, ne kemi parë dhe më herët se  
17 kush është regjistruar në këtë dokument se kush ka qenë i  
18 pranishëm në këtë takim - z. Veseli nuk ka qenë i pranishëm në  
19 këtë takim? Ju nuk e keni parë besoj z. Veseli aty. Është e  
20 saktë kjo, Dëshmitar?

21 PË. Jo, jo, nuk ka qenë z. Veseli.

22 PY. A ju kujtohet ndonjë diskutim lidhur me mungesën e tij,  
23 domethënë, në faktin që ai nuk ka qenë aty dhe ka qenë jashtë  
24 shteti?

25 PË. Ka pas diskutime të ndryshme. Por nuk i mbaj mend folësit

1 dhe nuk e mbaj mend çka është fol. Kurse sa i përket kësaj,  
2 këtij shkrimi, nuk e di as që kush e ka shkru dhe ka kush ka -  
3 - nuk po më kujtohet që ka pas dhe dikush që ka mbajt  
4 procesverbal në atë takim.

5 PY. Po, mos u shqetësoni se kush e ka shkruar këtë  
6 procesverbal, po thjesht po ju pyes në qoftë se ju kujtohet se  
7 ka pasur ndonjë diskutim gjatë asaj kohe që z. Veseli nuk ka  
8 qenë aty po ka qenë jashtë. A ju kujtohet kjo?

9 PË. Z. Veseli nuk ka qenë në atë takim.

10 PY. Në rregull. Faleminderit.

11 Të kalojmë më vonë në kohë - dokumenti mund të hiqet nga  
12 ekрани ndërkohë - kalojmë tek takimi i radhës, pra, bëhet  
13 fjalë për një takim të disa anëtarëve të Shtabit të  
14 Përgjithshëm dhe komandantëve të zonave. Është takim i cili  
15 pretendohet që të ketë ndodhur më datë 13 shkurt 1999.

16 Z. DIXON: [Përkthim] Më konkretisht është prova gjyqësore  
17 1D33. Nuk është e nevojshme që të shfaqet në ekran dokumenti

18 PY. Megjithatë në përmbledhje mund t'ju them që ky është  
19 takimi në të cilin juve morët rolin si komandant i  
20 përgjithshëm i UÇK-së, a ju kujtohet kjo, a është e saktë kjo,  
21 Dëshmitar?

22 PË. Po, e saktë.

23 PY. Edhe një herë, është e saktë, besoj, apo jo, që z. Kadri  
24 Veseli nuk ka qenë as në këtë takim, domethënë, nuk ka qenë i  
25 pranishëm as në takimin e 13 shkurtit të vitit 1999, është e

1 saktë kjo?

2 PË. Po, është e saktë.

3 PY. Ai nuk ka qenë i përfshirë në caktimin tuaj si komandant  
4 i përgjithshëm i UÇK-së? A është e saktë kjo?

5 PË. Po, e saktë.

6 PY. Pasi u caktuat si komandant i përgjithshëm i UÇK-së, ju  
7 thatë që keni qëndruar në këtë rol rreth gjashtë javë deri në  
8 bombardimet e NATO-s deri në fund të marsit. Gjatë kësaj  
9 periudhe, a keni marrë pjesë në ndonjë takim të Shtabit të  
10 Përgjithshëm ose të disa personave nga Shtabi i Përgjithshëm  
11 gjatë asaj periudhe? A ju kujtohet të keni marrë pjesë në  
12 ndonjë takim të kësaj natyre?

13 PË. Më kujtohet se e kam mbajtur një takim mbasi jam zgjedhur  
14 komandant i Shtabit të Përgjithshëm.

15 PY. Dje ju treguan disa procesverbale - më konkretisht për  
16 procesverbal bëhet fjalë për dokumentin 645 - një tjetër takim  
17 i datës 26 shkurt 1999. Nuk është e nevojshme që ta shfaqim në  
18 ekran. Megjithatë dua t'ju pyes në qoftë se juve ju kujtohet  
19 të keni marrë pjesë në takime të organizuara përreth asaj  
20 kohe, domethënë, nga fundi i shkurtit të 1999?

21 PË. E di që e kam mbajtur një takim. E kam mbajtur një takim me  
22 anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm, me disa anëtarë të Shtabit  
23 të Përgjithshëm në një fshat. Domethënë, afër në Berishë a nuk  
24 e di ku.

25 PY. Në rregull. Ju këtu thoni se "disa anëtarë të Shtabit të

1 Përgjithshëm". Është e drejtë të thuhet, është e saktë të  
2 thuhet që z. Kadri Veseli nuk ka qenë pjesë e këtij takimi,  
3 kështu, Dëshmitar?

4 PË. Po, është e saktë.

5 PY. Në fakt, ai nuk ka marrë pjesë në asnjë takim të  
6 organizuar prej jush ose ku ju keni marrë pjesë ndërkohë që  
7 keni qenë pjesë ose keni qenë në pozicionin e komandantit të  
8 përgjithshëm të UÇK-së, përveç rastit kur jeni takuar me të në  
9 fund të marsit në Nerodimë. A është e saktë kjo?

10 PË. Po, është e saktë. Dhe si komandant zone dhe komandant i  
11 përgjithshëm asnjëherë nuk ka qenë në takim Kadri Veseli.

12 PY. Kur keni qenë komandant i përgjithshëm, ju nuk e keni  
13 thërritur ndonjëherë atë, domethënë, apo nuk keni folur me atë  
14 ndërkohë që keni pas mbledhje ose nuk është se keni pas takime  
15 të tjera me të --

16 PË. Jo.

17 PY. -- të ndryshme, kështu?

18 PË. Jo, nuk kam pas takime.

19 PY. Atëherë dua t'ju pyes lidhur me atë që ju thatë pak më  
20 parë që e keni parë atë me disa të tjerë. Kjo ka ndodhur  
21 ndërkohë që ju donit që të tërhiqeshit si komandant i  
22 përgjithshëm i UÇK-së në fund të marsit, ju thoni që e keni  
23 takuar, e keni parë atë në Nerodimë. Thoni gjithashtu që ju  
24 donit që ai të zëvendësohej nga z. Çeku sepse mendonit që z.  
25 Çeku ishte më i kualifikuar se z. Veseli. Këtë e keni thënë në

1 dëshminë tuaj, është e pasqyruar po ashtu dhe në paragrafin 98  
2 të Shënimit Përgatitor numër 2.

3 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

4 PË. Ajo është ose përkthimi ose është gabim se nuk kam thënë  
5 se z. Veseli të ndërrohet me z. Çeku, po kam thënë unë të  
6 ndërrohem me z. Çeku.

7 PY. Po. Këtë po thoja dhe unë. Tani u tha siç duhet. Atëherë  
8 është e vërtetë, apo jo, që Veseli dhe grupi me të cilin ishte  
9 ai u munduan që t'ju bindnin ju të mos tërhiqeshit, a është e  
10 saktë kjo?

11 PË. Sa më kujtohet po. Më ka thënë që të mos tërhiqem edhe të  
12 shohim. Dhe i kam thënë që unë mendoj që duhet, është më mirë  
13 që të jetë gjeneral Çeku.

14 PY. Fakti është që ju nuk u pajtuat me këtë dhe vendosët që  
15 të tërhiqeshit, të largoheshit, domethënë, ishte vendimi juaj  
16 ky që të largoheshit. A ndodhi kështu, Dëshmitar?

17 PË. Po.

18 PY. Atëherë, z. Veseli dhe askush nga personat e tjerë aty  
19 nuk është se kishin kontroll mbi ju që t'ju detyronin në një  
20 farë mënyre ose t'ju bindnin juve që të qëndronit aty. Ju mund  
21 të largoheshit nëse e shikonit të arsyeshme dhe, në fakt, atë  
22 bëtë, u larguat. A është e saktë kjo?

23 PË. Po, e saktë.

24 PY. Ju thoni në dëshminë tuaj se Qeveria e Përkohshme filloi  
25 që të formohej pas bisedave në Rambuje, sepse ky ishte hapi

1 tjetër logjik që të krijohej një qeveri e përkohshme për  
2 Kosovën. A ju kujtohet që ta keni thënë këtë?

3 PË. Po.

4 PY. A ju kujtohet se z. Kadri Veseli ishte një ndër personat  
5 që do ishte pjesë e Qeverisë së Përkohshme si shef i shërbimit  
6 inteligjent civil të Kosovës rreth kësaj periudhe, domethënë,  
7 pak kohë pasi ju u takuat me të?

8 PË. Nuk e di. Nuk e di më si ka shku rrjedha e takimeve.

9 PY. Do t'ju tregoj një komunikatë që është nxjerrë gjatë  
10 kësaj periudhe.

11 Z. DIXON: [Përkthim] Për procesverbal bëhet fjalë për  
12 dokumentin 1D70. Do i lutesha Sekretares ta paraqesë në ekran.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Nuk e gjej këtë  
14 dokument as tek lista e materialeve të ZPS-së dhe as tek lista  
15 e materialeve të Veselit.

16 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

17 Z. DIXON: [Përkthim] Duket sikur nuk është më tek lista e  
18 dokumenteve, nuk e di arsyen për këtë. Është një dokument i  
19 cili është treguar shumë dëshmitarëve. Të nderuar Gjykatës,  
20 nuk e di në qoftë se mund të kërkoj që t'i tregohet ky  
21 dokument. Është 1D00070.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë  
23 kundërshtim?

24 Z. HALLING: [Përkthim] Ai e njeh dokumentin po nuk është  
25 se do thotë ndonjë gjë shumë të madhe lidhur me të.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ishte kjo  
2 pyetje.

3 Mund të vazhdoni, Dixon.

4 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit. Thjesht dua t'ia  
5 tregoj dëshmitarit dhe ta pyes lidhur me të.

6 Faleminderit.

7 PY. Z. Selimi, kjo është një komunikatë e Qeverisë së Kosovës  
8 e datës 2 prill 1999. A e keni parë më përpara këtë  
9 komunikatë, Dëshmitar? A e njihni këtë dokument?

10 PË. Po, është dokument i qeverisë së Kosovës që është lëshu  
11 më 2 prill, po nuk e kam pa asnjëherë.

12 PY. Në rregull. A mund t'ju pyes në qoftë se në këtë periudhë  
13 e keni ditur që njerëz po caktoheshin si ministra ose në poste  
14 të ndryshme të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, a keni pas  
15 dijeni për këtë zhvillim?

16 PË. Po, e saktë. Po e kam dit për këtë zhvillim.

17 PY. Kishte shumë ricaktime rolesh, domethënë, duke përfshirë  
18 edhe juve, domethënë, ju keni marrë pozicione të reja, po ka  
19 pas dhe persona të tjerë të cilët kanë marrë pozicione të  
20 ndryshme, pra, kanë ndryshuar role që i kishin pasur më herët.  
21 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

22 PË. Po, e saktë.

23 PY. A ju kujtohet në qoftë se z. Kadri Veseli kaloi nga UÇK-  
24 ja, nga G2 që përmendëm ne, domethënë, nga G2 kaloi tek  
25 zbulimi i shërbimit civil në atë periudhë kohore, ju kujtohet



1 kjo?

2 PË. Po, më kujtohet.

3 PY. A është e vërtetë që shërbimi informativ civil i Kosovës  
4 u njoh, njihej si SHIK-u?

5 PË. Po, e saktë.

6 PY. A ka qenë kjo hera e parë që filloi të ekzistonte SHIK-u  
7 si një organ formal?

8 PË. Besoj që po.

9 PY. Faleminderit. Do t'ju bëj dhe nja dy pyetje të tjera për  
10 Shtabin e Përgjithshëm, e para syresh lidhet me provën 142.

11 Kjo ishte një kërkesë që ua treguam dhe dje, ishte një  
12 kërkesë që ia keni dërguar ju Shtabit të Përgjithshëm që t'ju  
13 jepte fonde, financa. Ju kujtohet kjo?

14 PË. Po, më kujtohet.

15 PY. Në faqen 93 të transkriptit të djeshëm ju thatë:

16 "Nuk e di në fakt a shkoi në duart e Shtabit të  
17 Përgjithshëm."

18 Saktë?

19 PË. Po.

20 PY. Ju kujtohet?

21 PË. Po, e saktë.

22 PY. Po a nuk morët ndonjë kundërpërgjigje ju nga Shtabi i  
23 Përgjithshëm për kërkesën tuaj, pra, këtë doni të thoni që ju  
24 nuk morët asnjë reagim nga Shtabi i Përgjithshëm për kërkesën  
25 tuaj?

1 PË. Sa më kujtohet, nuk kam pas ndonjë përgjigje.

2 PY. Domethënë, nuk u bë asgjë, nuk patët asnjë komunikim nga  
3 Shtabi i Përgjithshëm për këtë, apo jo, kështu?

4 PË. Sa më kujtohet mu, jo, nuk kemi pas.

5 PY. Pra, ju e trajtuat vetë çështjen pastaj. Edhe madje ju  
6 thatë që nuk ju kujtohet a morët ndonjëherë fonde?

7 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtoj, është bërë pyetja, ka  
8 marrë përgjigje.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet,  
10 mund t'i përgjigjeni pyetjes, Dëshmitar.

11 DËSHMITARI: Rreth kësaj çështjeje jam marrë vetë me Zonën  
12 Operative të Drenicës.

13 Z. DIXON: [Përkthim]

14 PY. A është e saktë, flasim për vitin 1998 kur është bërë  
15 kërkesa, a është e vërtetë pra, që ju nuk e dinit si  
16 funksiononte Shtabi i Përgjithshëm brenda përbrenda? Ju e  
17 dinit çfarë ndodhte në zonën tuaj, por nuk e dinit çfarë  
18 ndodhte brenda Shtabit të Përgjithshëm, saktë?

19 PË. Jo, se dhe asnjëherë s'e kam dit si ndodhej dhe si ka  
20 qenë i organizu Shtabi i Përgjithshëm.

21 PY. Kur ju personalisht u bëtë komandant i përgjithshëm në  
22 Shtabin e Përgjithshëm filluat të mësonit diçka më shumë, apo  
23 jo?

24 PË. Po, e saktë.

25 PY. A është e vërtetë - sepse kemi parë disa nga mbledhjet që

1 kemi mbajtur - që ndonjëherë personat vinin në mbledhje, herë  
2 të tjera nuk vinin, saktë?

3 PË. Mund të them e saktë, po.

4 PY. Pra, a mund të themi që ky ishte në fakt një organizim  
5 rastësor, ndonjëherë personat ishin të pranishëm, ndonjëherë  
6 personat nuk ishin të pranishëm? Nuk është se Shtabi i  
7 Përgjithshëm ishte gjatë gjithë kohës në të gjitha mbledhjet  
8 dhe nuk komunikonin gjatë gjithë kohës me njëri-tjetrin, ishte  
9 diçka rastësore, sporadike më saktë?

10 PË. Po, është e saktë.

11 PY. Do t'ju bëj një pyetje lidhur me z. Ferit Shala.

12 Ju thatë se z. Ferit Shala ka qenë shefi i njësitit ose  
13 drejtuesi i njësitit Pëllumbi. Kjo është thënë në shënimin  
14 përgatitor në paragrafin 45 edhe dëshmuat edhe dje lidhur me  
15 këtë në faqen 115, në qoftë se nuk e kam gabim.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Para dy ditësh ka folur lidhur me  
17 këtë.

18 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

19 PY. Ju thatë që diku nga prilli nga maji, ai, z. Ferit Shala  
20 u largua për t'u bërë pjesë e Shtabit të Përgjithshëm. Por ju  
21 nuk e dinit se çfarë detyrash kishte ai pranë Shtabit të  
22 Përgjithshëm. A ju kujtohet që e keni thënë këtë?

23 PË. Jo, Ferit Shala, po Ferat Shala.

24 PY. Ju kërkojmë ndjesë, shqiptimi është faji ynë. Po, Ferat  
25 Shala, po.

1 PË. Po, më kujtohet. Po, më kujtohet. Dhe ashtu ka qenë.

2 PY. Tani dua t'ju pyes pak për datat, se kemi dëgjuar dëshmi  
3 prej z. Bislime Zyrapi në këtë Gjykatë dhe do ju them dhe madje  
4 çfarë ka thënë ai si shef shtabi i UÇK-së.

5 Z. DIXON: [Përkthim] Për ata që po na ndjekin, po i  
6 referohem faqes 18426 të transkriptit.

7 PY. Po ju lexoj çfarë ka thënë ai. Kur i bënë pyetje për  
8 Ferat Shalën ai tha:

9 "Unë e di që në 1998, deri nga fundi i 1998, ka qenë  
10 komandant i njësitit Pëllumbi në fshatin Negroc pranë  
11 Llapushnikut. Në atë pozitë ka qenë. Dhe më pas u transferua  
12 dhe u rrit në detyrë. Nuk e di se çfarë pozite mori më pas."

13 Këtë ka thënë z. Zyrapi. Tha që ka qenë komandant i  
14 njësitit Pëllumbi deri në fund të vitit 1998. Tani ju vazhdoni  
15 të thoni atëherë që ai ka qenë atje deri nga prilli, maji 1998  
16 në atë rol, pra, a mund të ketë qenë, mund ta ketë pasur edhe  
17 më vonë këtë pozitë duke u bazuar në atë që ka thënë z.  
18 Zyrapi?

19 PË. Nuk jam i saktë. Edhe nuk e di saktësisht. Po saktë ka  
20 qenë komandant i pikave Pëllumbi. Kur ka edhe në -- sa ka  
21 qëndru. E di se ka qenë edhe në -- kur ka qenë në Gryka e  
22 Llapushnikut pjesëmarrës. Pas kësaj nuk e di sa ka zgjatë kur  
23 ka shku në Shtabin e Përgjithshëm. S'më kujtohen datat.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Dixon, a mund ta pyesni  
25 dëshmitarin deri kur ekzistoi njësitit Pëllumbi? Se mbase

1 kështu mund të kuptojmë dhe datat.

2 Z. DIXON: [Përkthim]

3 PY. Dëshmitar, e dëgjuat në fakt pyetjen e Gjykatësit

4 Mettraux.

5 PË. Po.

6 PY. Deri kur ekzistoi njësitit Pëllumbi?

7 PË. Njësitit Pëllumbi derisa sa është formu Brigada 113 edhe  
8 ka kalu në kuadër të Brigadës 113, njësitit Pëllumbi. Mirëpo  
9 edhe në kuadër të Brigadës 113 e ka pas ky grup njësitit emrin  
10 njësitit Pëllumbi edhe në këtë kohë dhe në këtë aspekt, në këtë  
11 pjesë ka qenë Ferat Shala me njësit.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ju kujtohet, Dëshmitar,  
13 kur u krijua 113, Brigada 113?

14 DËSHMITARI: Dikun ka fillu nga qershori më duket. Pasi  
15 jam zgjedhur unë komandant i zonës së Drenicës, unë kam fillu  
16 me konsolidimin e brigadave.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit ju.

18 Dhe faleminderit, z. Dixon.

19 Z. DIXON: [Përkthim]

20 PY. Dua t'ju bëj një pyetje vijuese. Ju thatë që njësitit  
21 vazhdoi të ekzistonte brenda Brigadës 113. Pra, vazhdoi të  
22 kishte të njëjtin emërtim ky njësit edhe pas formimit të  
23 brigadave, saktë?

24 PË. Po, e saktë.

25 PY. Pra, a mund të ketë qenë atëherë në ekzistencë ky njësit

1 me z. Shala në krye edhe më vonë gjatë 1998, deri nga fundi i  
2 1998 konkretisht?

3 PË. Si njësi gjithmonë është thirr, domethënë, ka mundësi me  
4 poshtë, sa herë kemi kalu ose sa herë kemi pas kontakt është  
5 thirr me shifrën njësitit Pëllumbi, me shifrën Pëllumbi edhe  
6 pjesëtarë të tjerë kur kanë qenë në kuadër të Brigadës 113.

7 PY. Kur thoni ju që z. Shala ka qenë pranë Shtabit të  
8 Përgjithshëm më vonë, ju thatë që detyrat e tij ju nuk i dini?

9 PË. Jo, nuk i di. Është e saktë.

10 PY. Z. Zyrapi, në dëshminë e tij, na tha po ashtu që ai nuk e  
11 ka ditur çfarë posti, çfarë pozite ka pasur z. Shala. E  
12 dëgjuat se ua lexova, apo jo?

13 PË. Po, e saktë.

14 PY. Pra, z. Zyrapi nuk thotë që ka qenë pjesë e Shtabit të  
15 Përgjithshëm apo të ketë qenë pranë Shtabit të Përgjithshëm.  
16 Ju vazhdoni të thoni që ai ka shkuar në Shtabin e Përgjithshëm  
17 për të qenë pjesë e shtabit?

18 PË. Ai, faktikisht, më nuk ka qenë në njësitin Pëllumbi. Nuk  
19 e di për sa kohë. Por e di që ka kalu në Shtabin e  
20 Përgjithshëm. Periudhën nuk e di. Detyrat e tina nuk i di. Dhe  
21 çfarë roli ka pas ose a ju ka caktuar a nuk ju ka caktu.

22 PY. Në rregull. Ju nuk keni pasur kontakte me të kur u  
23 largua, apo jo?

24 PË. Nuk kam pas kontakte.

25 PY. Faleminderit. Tani do t'ju bëj një pyetje për përdorimin

1 e fjalës, termit "Luli".

2 Z. DIXON: [Përkthim] Kjo është thënë në Shënimin  
3 Përgatitor 2, paragrafi 83.

4 PY. Po ua lexoj dhe më pas do t'ju bëj disa pyetje lidhur me  
5 të.

6 Ju keni thënë që ju besonit se z. "Kadri Veseli ishte  
7 'Luli', por nuk jeni i sigurtë edhe e keni thënë se mund të  
8 ketë pasur edhe ndonjë person tjetër me këtë emër."

9 A ju kujtohet që t'ia keni thënë këtë Prokurorisë?

10 PË. Po, e saktë.

11 PY. Kur thoni ju që mund të ketë pasur edhe një person tjetër  
12 me këtë emër, a keni pasur ndonjë person konkret në mendje,  
13 apo shkurtimi Luli mund të përdoret gjerësisht?

14 PË. Jo, nuk kam ndonjë rast konkret, por ashtu kam mendu.

15 PY. Po a është e vërtetë në fakt që nofka "Luli" përdorej  
16 gjerësisht në atë kohë në Kosovë dhe, në fakt, ishte shkurtesë  
17 e emrit Lulëzim apo ndonjë emri tjetër?

18 PË. Këtë nuk e di.

19 PY. Në rregull. Faleminderit. Tani dua t'i kthehem pikës që  
20 filluam dje ta diskutonim lidhur me z. Kiçina. Ju bë pyetje  
21 nëse ishte pjesë e grupit të Sabit Gecit. A ju kujtohet që ju  
22 bënë pyetje për këtë dje dhe ju thatë, jo, ai nuk ka qenë  
23 pjesë e grupit të Sabit Gecit?

24 PË. Po, e saktë.

25 PY. Më pas ju bënë pyetje për z. Geci dhe pretendimet për

1 Personin 1, po i themi këtij personit Personi 1, ju u  
2 përgjigjët Prokurorisë kështu, kur thatë që keni folur me z.  
3 Geci për këtë çështje. Ju thatë:

4 "Ua kam shpjeguar këtë. Ata thonë që kanë vepruar në emër  
5 të SHIK-ut asokohe."

6 Kjo është thënë në faqen 122 të transkriptit:

7 "Dhe personat që ishin me të një a dy, nuk më kujtohen,  
8 Ismet Haxhiu që e di që ka qenë atje, ai përfshiu SHIK-un,  
9 përmendi SHIK-un. Dhe ua kam shpjeguar këtë dhe herën e parë  
10 edhe në deklaratat e mia për Personin 1."

11 Dhe ju bënë një pyetje ju: Po në këtë rast a thanë ata  
12 për llogari të kujt po vepronin ata, për llogari të kujt nga  
13 SHIK-u?

14 Ju thatë:

15 "Ata nuk e thanë për llogari të kujt po vepronin, por ata  
16 thjesht thanë ne po veprojmë në emër të Shik-ut."

17 "Dhe më pas, besoj se doli që kjo s'ishte e vërtetë,  
18 rezultoi që kjo nuk ishte e vërtetë."

19 Më pas vijuat dhe thatë:

20 "Ata u prezantuan si të SHIK-ut dhe përmendën emrin e  
21 Kadri Veselit dhe thanë kinse po vepronin në emër të tij, por  
22 nuk treguan asnjë dokument për ta mbështetur këtë. U kërkova  
23 sqarime në atë kohë, shpjegime e sqarime."

24 Që ta përfundojmë për kontekst dhe ju thatë pastaj që:

25 "Sabit Geci kishte, bënte kontrolle mjekësore, ishte nën



1 trajtim mjekësor në atë kohë edhe shkonte sa në një vend në  
2 një vend tjetër dhe përfundimisht shkoi në Shqipëri për  
3 trajtime mjekësore të mëtutjeshme. Ndërsa Ismet Haxhiu shkoi  
4 në Shalë në Zonën Operative të Shalës.”

5 A ju kujtohet kjo dëshmi?

6 PË. Po.

7 PY. Tani, unë do t'ju pyes për këtë pjesë, veçanërisht kur  
8 thatë:

9 “Më pas, besoj se rezultoi se nuk ishte e vërtetë.”

10 A është e vërtetë, z. Selimi, që ju zbuluat më vonë se në  
11 fakt nuk ishte e vërtetë, pra, ata nuk kishin vepruar për  
12 llogari të SHIK-ut apo për ndonjë njësit të shërbimit  
13 informativ dhe nuk kishin vepruar në emër të z. Veseli? Këtë  
14 keni dashur të thoni?

15 PË. Po.

16 PY. Si e zbuluat ju këtë gjë?

17 PË. Sepse unë z. Veseli as nuk kisha kontakt, por nuk ishte  
18 një shërbim i tillë, nuk kisha ndëgjju dhe nuk kishte në Zonën  
19 Operative të Drenicës, as nuk kisha ndëgjju.

20 PY. Po. A është e vërtetë, pra, që nuk kishte SHIK në atë  
21 kohë. SHIK-u u krijua më vonë në 1999. Por në 1998, nuk  
22 ekzistonte SHIK-u, e lë më pas të operonte në zonën tuaj,  
23 s'ekzistonte fare, apo jo?

24 PË. E saktë.

25 PY. Ju thatë që z. Geci dhe të tjerët përfshinë SHIK-un,

1 përmendën dhe përfshinë. A po thoni tani, në fakt, që ju e  
2 dini që ka qenë e pavërtetë se, në fakt, ata nuk punonin as  
3 për SHIK-un as për ndonjë shërbim tjetër informativ në atë  
4 kohë?

5 PË. Dhe atëherë kam dyshu edhe atëherë edhe tash besoj që nuk  
6 ka qenë e saktë. Po ata vetëm janë thirr me emra të ndryshëm.

7 PY. Po. Kur thoni që ju dyshuat që në atë kohë, në fakt ju  
8 keni thënë në dëshminë tuaj kur pyeti ZPS-ja që ju kërkuat  
9 shpjegime e sqarime në atë kohë për këtë --

10 PË. Mesa më kujtohet --

11 PY. -- pra, qysh atëherë i kishit dyshimet, apo jo?

12 PË. Faktikisht, po. Dhe sa më kujtohet kam kërku sqarime dhe  
13 kam thënë që këto gjena më mos të ndodhin dhe mos të thirret  
14 dikush në emën të Zonës Operative të Drenicës apo në emra të  
15 ndryshëm.

16 PY. Në atë kohë ua the këtë atyre apo ua the më vonë këtë  
17 gjë?

18 PË. S'më kujtohet saktë. Nuk e di, po mendoj që aty për aty e  
19 kam thënë.

20 PY. A është e vërtetë atëherë që ju po thoni që kur ta thanë  
21 ata ty këtë gjë, ti as atëherë nuk i besove dhe as tani nuk e  
22 beson këtë gjë, saktë?

23 PË. Është e saktë.

24 PY. Kur ata thanë se kinse po vepronin për llogari të z.

25 Veseli, ju nuk e besuat atëherë, apo jo dhe prapë as tani nuk

1 e besoni, apo jo?

2 PË. As atëherë s'e kam besu, as tash.

3 PY. Që të jemi 100 për qind të qartë për këtë. Ju thatë që  
4 nuk keni pasur kontakte me z. Veseli. Dhe po i referohem faqes  
5 21, rreshti 14. Saktë? Në atë kohë dhe as më pas asnjëherë nuk  
6 keni shkuar ta kontaktoni z. Veseli që ta verifikonit këtë  
7 çështje?

8 PË. Jo, nuk kam pas edhe qysh me e taku për arsye se nuk ka  
9 qenë në Drenicë. Nuk e di ku ka qenë. Dhe s'e kam taku rreth  
10 kësaj çështjeje.

11 PY. Në asnjë moment në 1998 apo 1999, pra, për këtë çështje  
12 nuk e keni trajtuar ndonjëherë këtë me z. Veseli, apo jo?

13 PË. Besoj që jo, asnjëherë.

14 PY. Në Shënimin Përgatitor 1, paragrafi 8, ju i keni quajtur  
15 këtë grup nën drejtimin e Gecit, "një njësit të ashtuquajtur  
16 informativ", dhe keni thënë se ata i referoheshin vetes ose si  
17 shërbim informativ ose si SHIK-u, pra, ata. Ju e përdorët këtë  
18 formulim, sepse, domethënë, ju e thatë këtë sepse, në fakt,  
19 nuk ka ekzistuar një njësit i tillë?

20 PË. E thashë edhe më herët, se si njësit nuk e di që ka  
21 ekzistuar, por këta dy persona janë thirr me emër të këtij SHIK-  
22 ut domethënë.

23 PY. A është e vërtetë, që SHIK-u ka qenë emri i shërbimit  
24 informativ të Shqipërisë para luftës, që para luftës 1997 dhe  
25 ka qenë një akronim që u përdor sepse u huazua nga Shqipëria

1 për t'iu referuar shërbimit informativ, saktë?

2 PË. Po, e saktë.

3 PY. Thatë që ky grup apo ky grup i ashtuquajtur nuk ka pasur  
4 asnjë rol në zonën tuaj. Nuk kanë qenë ndonjë grup zyrtar?

5 PË. Jo, jo. Saktë.

6 PY. Ju po ashtu keni thënë se ju u thatë atyre se ata nuk  
7 duhet të vazhdonin të pretendonin se ishin një grup zyrtar apo  
8 ishin ndonjë njësit zbulimi apo SHIK-u. Ta dëgjuan fjalën ata?

9 PË. Besoj që më nuk kanë vepru, nuk janë thirr më me këtë  
10 emër.

11 PY. Mesa keni ju dijeni mos filluan ta quanin grupin e tyre  
12 me ndonjë emërtim tjetër, për shembull, filluan të quheshin  
13 policia ushtarake?

14 PË. Jo, jo. Nuk është, s'ka -- kjo s'ka të bëjë në lidhje me  
15 policinë ushtarake.

16 PY. Po, e di, e di. Po a e dini ju mos Geci dhe shokët e tij  
17 filluan të thonin që "Ne jemi policia ushtarake", a "policia e  
18 fshehtë ushtarake", vetë ata ta quanin veten kështu?

19 PË. S'e kam dëgju ndonjëherë.

20 PY. Dua t'ju lexoj një pjesë të një dëshmie të lëndës kundër  
21 z. Geci për krimet që janë kryer në Shqipëri, jo në Kosovë por  
22 në Shqipëri, në prill të 1999, kur një dëshmitar --

23 Z. DIXON: [Përkthim] Do jua jap dhe referencën palëve,  
24 është prova P01584 në faqen 8 kjo që do të përmend unë.

25 PY. Ky dëshmitar, [REDAKTUAR] ka thënë që Geci i ka thënë atij

1 që:

2 "... 'Unë jam shefi i policisë ushtarake të Kosovës, a më  
3 njihni mua?'"

4 A keni dëgjuar ju më përpara për këtë gjë?

5 PË. Jo, tash po ndëgjoj.

6 PY. A pajtoheni me mua, Dëshmitar, se Geci dhe grupi i tij,  
7 pavarësisht emërtimit të tyre, ishin një grup i vetorganizuar  
8 që nuk i jepnin llogari askujt?

9 PË. Dhe dua të cek se në këtë periudhë z. Geci ka qenë  
10 gjithmonë në shoqërim të mjekëve për arsye se ka qenë i  
11 plagosur. Dhe rreth tij njerëz që e kanë ndihmu, ka pas njerëz  
12 të cilët -- më falni, njerëz të cilët i ka pas afër vetes që e  
13 kanë ndihmu për lëvizje. Dhe në këtë rast, me një rast të  
14 caktum them se janë thirr me këtë emër. Pastaj kanë lëvizë dhe  
15 nuk kanë qenë -- nuk ka qenë i sistemum në Zonën Operative të  
16 Drenicës.

17 PY. Po. Do flasim dhe për trajtimin mjekësor pas pushimit. Po  
18 a është e vërtetë që ai sa herë mundej shkonte në drejtime të  
19 ndryshme. Ka qenë shumë i plagosur rëndë, siç thatë dhe ju,  
20 por ai vepronte vetë me kokën e tij dhe nuk i përgjigjej as --  
21 nuk i jepte llogari askujt, apo jo?

22 Z. HALLING: [Përkthim] E kundërshtoj, shtrembëron  
23 dëshminë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ishte thjesht  
25 një pyetje.

1 Mund t'i përgjigjeni, Dëshmitar.

2 DËSHMITARI: Po, është e saktë. Domethënë, nuk është --  
3 nuk i ka dhënë llogari Zonës Operative të Drenicës.

4 Z. DIXON: [Përkthim]

5 PY. Po. Dhe nuk i raportonte askujt as në Shtabin e  
6 Përgjithshëm, apo jo?

7 PË. Në atë kohë nuk e di.

8 Z. DIXON: [Përkthim] Nëse mundemi para pushimit apo si  
9 propozoni, Gjykatës, ta bëj pas pushimit?

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].  
11 [Përkthim] Po ju përgjigj pyetjes.

12 Z. DIXON: [Përkthim] Po jo është një pyetje tjetër.

13 Ju lutem vendosni në ekran materialin SITF00364447 deri  
14 në 00364456.

15 PY. Dëshmitar, kjo është një pjesë e dëshmisë që keni dhënë  
16 ju në lëndën Hasani, për këtë jeni intervistuar në 2013. Do  
17 t'ju pyes lidhur me dy pyetje dhe përgjigje që keni dhënë për  
18 z. Ismet Haxha.

19 Z. DIXON: [Përkthim] Kjo është e pasqyruar në faqen 4 të  
20 dokumentit në anglisht.

21 PY. Nuk është e përkthyer në shqip kjo, unë po ua lexoj  
22 sidoqoftë. Shohim pyetjen 8. Po ua lexoj dhe më pas mund t'i  
23 përgjigjeni pyetjeve. Ju keni thënë -- pyetja ishte kjo:

24 "A e njihni Ismet Haxhën?"

25 Ju i jeni përgjigjur:

1 "E njoh tani. Nuk më kujtohet nëse e kam njohur gjatë  
2 kohës së luftës. E di që ka qenë ushtar i UÇK-së dhe ka qenë  
3 aktiv në atë kohë por ai ka qenë në Zonën Operative të Shalës.  
4 Ai nuk ka qenë nën drejtimin tim, nën komandën time. Jam i  
5 sigurtë se ai nuk ka marrë asnjë detyrë prej Shtabit të  
6 Përgjithshëm apo qoftë nga shtabi i Drenicës."

7 Ju kujtohet kjo deklaratë, kjo pjesë e dëshmisë në këtë  
8 lëndë gjyqësore?

9 PË. Po, më kujtohet.

10 PY. Dhe është e vërtetë, apo jo? Po flasim këtu për Ismet  
11 Haxhën që, në fakt, ishte pjesë e grupit të Gecit dhe kjo  
12 është dëshmia juaj lidhur me detyrat që merrte ky person, prej  
13 kujt i merrte detyrat ky person?

14 PË. Në takimin kur me rastin që ka -- është paraqit dhe e kam  
15 deklaruar dhe ma herët, është, ka qenë me Sabit Gecin edhe  
16 Ismet Haxha -- më fal. Dhe atëherë kam thënë që Ismet Haxha ka  
17 shku në zonën e -- ka shku në pjesën, ka shku në zonën e  
18 Shalës dhe Sabiti ka qenë në Drenicë derisa ka shku për  
19 Shqipëri.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të  
21 bëjmë pushimin tani.

22 Z. DIXON: [Përkthim] Kisha dhe një pyetje, po mund ta  
23 bëjmë pas pushimit.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë  
25 dhjetë minuta pushim, Dëshmitar. Faleminderit. Mund të

1 largoheni nga salla e gjyqit.

2 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë dhjetë  
4 minuta pushim.

5 --- Seanca ndërpritet në orën 12.02

6 --- Seanca rifillon në orën 12.11

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem  
8 silleni dëshmitarin në sallë.

9 A mund të na thoni dhe sa kohë ju duhet, z. Dixon.

10 Z. DIXON: [Përkthim] Besoj që do përfundoj deri në  
11 pushimin e drekës.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
13 Nuk po ju kërkoj që të nxitoheni, po thjesht për arsye  
14 informimi po ju pyes.

15 Z. DIXON: [Përkthim] Po. Kam kohë më duhet.

16 [Dëshmitari vijon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Selimi,  
18 Mbrojtja e z. Veseli do të vazhdojë me pyetjet. Ju lutem  
19 dëgjojeni me vëmendje.

20 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

21 PY. Z. Selimi, do t'ju pyes lidhur me një dokument që e keni  
22 akoma në ekran. Është një dokument që ju e komentuat pak më  
23 përpara dhe në ekran kemi atë çfarë ju thatë lidhur me z.  
24 Ismet Haxha.

25 Ju konfirmuat që po flisnit lidhur me një person dhe



1 thatë se kush ishte z. Geci. Megjithatë, dua që ta sqarojmë  
2 pak këtë. Ju thoni që:

3 "Unë jam i sigurt nuk ka dhënë ndonjë detyrë, nuk ka  
4 caktuar ndonjë detyrë nga Shtabi i Përgjithshëm apo Shtabi i  
5 Përgjithshëm i Drenicës."

6 A e thatë këtë gjë? Është e saktë kjo?

7 PË. Po. e saktë.

8 PY. Faleminderit.

9 Z. DIXON: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani.

10 PY. Tani vazhdojmë me atë çfarë po thonit ju sa i takon Sabit  
11 Gecit dhe lëndimeve të tij, plagëve të tij. Ju besoj do e keni  
12 ditur se ju keni qenë i përfshirë në procesin gjyqësor së  
13 bashku me të. Domethënë, e kam fjalën këtu për lëndën që ka të  
14 bëjë me Drenicën I, dhe jeni akuzuar së bashku me të. Ju të dy  
15 në këtë proces gjyqësor jeni deklaruar të pafajshëm,  
16 megjithatë, përpara sesa t'ju bëj pyetje të tjera lidhur me  
17 këtë, dua t'ju pyes në qoftë se ju kujtohet dëshmia e dhënë  
18 nga një mjek në këtë lëndë gjyqësore, që është Arben  
19 Grazhdani, që është ortoped dhe që e ka operuar z. Geci pasi u  
20 lëndua ai.

21 PË. Po në -- nuk më kujtohet ç'ka është bisedu në këtë  
22 proces.

23 PY. Pyetja ime është kjo: A ju kujtohet që ka pas një mjek,  
24 pra, ka qenë ky mjeku, z. Grazhdani që e ka operuar z. Geci  
25 pas plagosjes? Ju kujtohet kjo?

1 PË. Nuk e di sa mjekë kanë intervenu, por e di që kurimin e  
2 parë ose trajtimin e parë a ka marrë nga Fadil Beka. Por ka  
3 shumë mjekë të tjerë të cilët në atë kohë ose ma vonë, nuk e  
4 di, që e kanë trajtu z. Geci.

5 PY. Që ta kuptojmë siç duhet sa i takon kohës. Ai është  
6 plagosur në fund të shkurtit të '98-s në betejën e Likoshanit.  
7 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

8 PË. Po, e saktë.

9 PY. A ju kujtohet kjo që z. Grazhdani ka dhënë dëshmi në  
10 lëndën gjyqësore Drenica I, ku ka thënë që e ka bërë operacion  
11 z. Geci, dhe ka thënë që ky ka qenë një ndër personat e parë  
12 tek të cilët ka bërë operacion në qershor të vitit 1998. Që ai  
13 ka bërë operacion një prej këmbëve të tij. A ju kujtohet,  
14 Dëshmitar?

15 PË. Detajet nuk po -- s'më kujtohet, po besoj që është e  
16 saktë mbasi ka marrë pjesë në proces gjyqësor.

17 PY. Po.

18 Z. DIXON: [Përkthim] Do kërkoj të paraqitet një dokument  
19 që është përdorur në gjykim. Për procesverbal është dokumenti  
20 2D00006. Është një raport i dhënë nga z. Grazhdani nga viti  
21 2010, domethënë, shumë kohë më pas. Do i kërkoja Sekretares që  
22 ta paraqesë këtë dokument në anglisht dhe në shqip.

23 PY. Ky është një dokument i cili është përdorur në gjykimin  
24 tuaj. Është nga mjeku, e thashë dhe një herë që është një  
25 dëshmi e cila është dhënë shumë pas rastit, por ky mjek këtu

1 thotë që z. Geci "ka vuajtur disa plagosje nga armët e zjarrit  
2 në të dyja këmbët". A e shikoni këtë në paragrafin e dytë? Dhe  
3 thotë më tej teksti që z. Geci është operuar me 2 korrik në  
4 Likoc dhe me 2 qershor në Likoc dhe me 4 janar 1999 në  
5 Slloveni.

6 E shikoni këtë, Dëshmitar?

7 PË. Po, e shikoj.

8 PY. Kjo është në pajtim me atë çfarë keni thënë ju, apo jo,  
9 që ai u lëndua rëndë, duhej të operohej dhe ka lëvizur në  
10 vende të ndryshme për shkak të gjendjes që kishte. Dhe një  
11 ndër vendet ku ka qenë, ka qenë dhe Sllovenia për shkak se  
12 është operuar aty? A është e saktë kjo?

13 PË. Mendoj që është e saktë, nuk e di.

14 PY. A mund t'ju pyes në qoftë se ju kujtohet gjatë gjykimit  
15 është dhënë dëshmia nga mjeku sa i takon lëndime të pësuar  
16 nga z. Geci.

17 Z. DIXON: [Përkthim] Më konkretisht kjo dëshmi lidhet me  
18 dokumentin SITF00370159, për procesverbal. Nuk është e  
19 nevojshme që të paraqitet në ekran, po thjesht do e lexoj dhe  
20 do ju pyes në qoftë se e kujtoni apo jo.

21 PY. Mjeku thotë që ju e keni vizituar z. Geci, dhe po ashtu  
22 ka thënë që "nuk kishte të bënte vetëm thjesht me plagosjen e  
23 këmbëve, por kishte të bënte gjithashtu edhe me këmbën e  
24 majtë", sepse mjeku thotë që "z. Geci kishte gjithashtu  
25 lëndime në këmbën e djathtë, kishte gjithashtu edhe në bërryl

1 te pjesa e dorës.”

2 A ju kujtohet ju, Dëshmitar, që z. Geci ka pasur lëndime  
3 në të dyja këmbët?

4 PY. Unë e di si ka qenë i plagosur rëndë dhe e di si e ka me  
5 -- e kanë asistuar mjekët. Edhe kur ka lëvizur, ka lëvizur e kanë  
6 ndihmu edhe persona të tjerë që për me lëviz bashkë me ekipin  
7 mjek. Ka lëvizur herë me paterica herë me -- por nuk e di saktë  
8 ku ka qenë i lënduar.

9 PY. A ju kujtohet që ai të jetë vënë në allçi pas operacionit  
10 dhe allçia i mbulonte nga sipër te abdomeni, tek kraharori  
11 deri tek pjesa e këmbës poshtë? Ju kujtohet kjo?

12 PË. Jo, s'më kujtohen detajet tash, nuk e di.

13 PY. Edhe një herë mjeku ka dhënë dëshmi në gjykimin që unë e  
14 përmenda pak më herët, ai tha - nuk e di në qoftë se ju  
15 kujtohet apo jo - që z. Geci duhej që të qëndronte aty ndoshta  
16 për tre muaj. A ju kujtohet kjo si hollësi, Dëshmitar?

17 PË. Jo, detajet nuk më kujtohen. Nuk e di, por përderisa sa  
18 ka thënë mjeku, është e saktë, por mu nuk më kujtohen këto  
19 detaje gjatë këtij procesi.

20 PY. E kuptoj.

21 Z. DIXON: [Përkthim] Hollësitë, në fakt, janë regjistruar  
22 se janë dhënë nga mjeku. Me fjalë të tjera ato janë të  
23 regjistruara në dokumentin SITF 00270159.

24 PY. Keni thënë që ai ka lëvizur me paterica. A ju kujtohet që  
25 ai në fakt nuk mund të shkonte në distanca shumë të largëta me

1 paterica, sepse këmba që ishte jashtë allçiut, edhe këtë këmbë  
2 e kishte të lënduar, domethënë, kupa e gjurit e kësaj këmbë  
3 ishte lënduar kështu që ai nuk ecte shumë në distancë edhe me  
4 këto aparate që kishte? A ju kujtohet që doktori e ka thënë  
5 diçka të tillë në këtë proces gjyqësor, Dëshmitar?

6 PË. Nuk më kujtohet që e ka thënë në këtë proces gjyqësor, po  
7 unë po them prapë, që lëvizjet i ka pas shumë të kufizime edhe  
8 gjithmonë është trajtu me ekip mjekësor.

9 PY. Ai nuk pati mundësi që as të largohej nga dhoma se nuk  
10 mund të ecte dot, domethënë, mund të ecte vetëm për disa metra  
11 brenda për brenda dhomës, por jo më tej. A ju kujtohet kjo?  
12 Kjo është diçka tjetër për të cilën ka dhënë dëshmi mjeku.

13 PË. Thashë që nuk më kujtohet asnjë dëshmi që ka dhënë mjeku.

14 Z. DIXON: [Përkthim] Atëherë, procesverbali siç thashë  
15 ekziston, është dokumenti SITF00370168, lidhur me këtë temë.

16 PY. Dua t'ju pyes këtë pyetje: Si shkoi ai nga zona juaj në  
17 Shqipëri dhe kur ka ndodhur kjo, kur ka kaluar, kur ka shkuar,  
18 ka lëvizur nga zona juaj për në Shqipëri?

19 PË. Si ka shku në Shqipëri nuk e di, me kënd ka shku dhe si  
20 ka shku.

21 PY. Atëherë, është e drejtë apo jo, që duke pasur parasysh  
22 kushtet e tij ai nuk do ketë qenë në gjendje, ose ju  
23 personalisht nuk e keni parë që ai të kryente ndonjë detyrë në  
24 terren?

25 PË. E thashë edhe ma herët, ai lëvizjet i ka pas të kufizime

1 dhe ka pas probleme të shumta mjekësor.

2 PY. Ju nuk është se e keni parë ose nuk është e keni pas  
3 dijeni që ai të kryente ndonjë operacion në zonën tuaj. Është  
4 e saktë kjo, Dëshmitar?

5 PË. E saktë. Përveç këtij rasti [E pakuptueshme], tjetër rast  
6 nuk di, nuk më kujtohet që ka pas.

7 PY. Për kë rast e keni fjalën këtu?

8 PË. Me rastin që kam shpjegu edhe ma herët të Personit 1, që  
9 thatë, me një proces të cilët ka qenë ma herët.

10 PY. Ky është rasti Drenica I, apo jo?

11 PË. Po, e saktë. Jo, jo, jo, jo. Jo, Drenica I. Në një rast  
12 tjetër, domethënë që është në rastin e Personit 1. Mundesh me  
13 --

14 PY. Po, në rregull. Atëherë, sa i takon këtij rasti, ju thatë  
15 ose ju pretendoni që keni folur lidhur me të sa i takon këtij  
16 rasti. Kur keni folur me të lidhur me rast, ai a ka qenë në  
17 allçi, ka qenë i lënduar, ai ishte i pamundur për të lëvizur  
18 në atë kohë?

19 PË. Po, ai ka qenë i lënduar. Ka qenë në gjendje të vështirë.

20 PY. Nuk iu përgjigje pyetjes time lidhur me këtë. Ose ndoshta  
21 një pyetje tjetër plotësuese. A ishte në gjendje të ecte, të  
22 lëvizte, të vinte vërdallë në atë kohë?

23 PË. Vetëm me patericë ose dhe me ndihmën e dikujt.

24 PY. Bëhej fjalë vetëm brenda për brenda ambienteve të  
25 mbyllura, domethënë, brenda dhomës? E keni parë ndonjëherë ju

1 jashtë atë?

2 PË. S'më kujtohet që e kam pa jashtë.

3 PY. Sikurse e thatë, ca kohë më pas ju [Sipas përkthimit] u  
4 larguat për në Shqipëri. Nuk e dini se si shkoi në Shqipëri.  
5 Ju thoni që nuk keni pas kontakt më me të pasi keni folur  
6 lidhur me këtë rast, kështu?

7 PË. Unë e kam pa disa herë, por rreth këtyne çështjeve,  
8 domethënë nuk kam pas ndonjë problem ose ndonjë diçka rreth  
9 tijna.

10 PY. Pas këtij rasti kur folët ju për herë të parë me të,  
11 lidhur me Personin 1, ju e keni parë në këtë rast -- e keni  
12 pas -- e keni parë dhe më pas këtij rasti këtë person, apo jo?

13 PË. Besoj që po mbas këtij rast. Nuk më kujtohet saktë.

14 PY. Kur e keni parë pas këtij rasti, pas kësaj bisede, ende  
15 ka qenë i lënduar, i plagosur dhe nuk kishte mundësi që të  
16 lëvizte lirisht akoma, apo jo?

17 PË. Gjithmonë ka qenë i -- derisa ka shku për Shqipëri ka  
18 qenë me plagë, domethënë, ka qenë i lënduar.

19 PY. Faleminderit. Tani do të kalojmë tek pjesa mjekësore  
20 tani. Domethënë, do ta lë diskutimin për sa i takon aspekteve  
21 mjekësore dhe do shikojmë intervistën që ju keni dhënë në  
22 vitin 2003 UNMIK-ut. E përmendët pak më herët që keni  
23 diskutuar lidhur me rastin e Personit 1.

24 Është një deklaratë e cila është në lëndë gjyqësore,  
25 është në prova gjyqësore në këtë çështje. Është prova P2025.

1 Nuk do kërkoj që të paraqitet në ekran, po do pyes lidhur me  
2 disa pjesë të kësaj prove.

3 Për palët do bëj të ditur faqet, në mënyrë të tillë që të  
4 na ndjekin. Në faqen 1 dhe në faqen 2 kur u pyetët nga UNMIK-u  
5 se:

6 "Çfarë funksioni ka pasur Sabit Geci dhe vartësit e tij  
7 në atë kohë?"

8 Ju jeni përgjigjur që:

9 "Nuk e di se çfarë funksionesh ka pasur ai gjatë kësaj  
10 periudhe sepse ka qenë i plagosur në atë kohë. Por, ai  
11 gjithmonë ka qenë me njësinë e zbulim-kundërzbulimit. Kam  
12 dëgjuar që ai ka qenë komandant i njësisë së zbulim-  
13 kundërzbulim për Drenicën gjatë kësaj periudhe kohe."

14 A ju kujtohet ta keni thënë këtë në intervistën tua,  
15 Dëshmitar?

16 PË. Unë e kam sqaru që ky është thirr në këtë kohë edhe për  
17 këtë çështje që disa herë jemi duke folur. Në këtë rast të  
18 caktum një person që është anku, vëllau i Personit 1, edhe në  
19 këtë rast ky është thirr në këtë çështje. Në këtë çështje  
20 është thirr në emën të -- si shef i SHIK-ut, edhe besoj që e  
21 kam sqaru këtë.

22 PY. Këtë doja që të sqaroja me ju në fakt, që kur po flisni  
23 këtu që ai ka qenë komandant i njësitit të zbulim-  
24 kundërzbulim, atë të cilin e keni fjalën ju është pretendimet  
25 që ai kishte, domethënë, që ju po thoni tani që ka qenë



1 pretendime që kanë qenë të rreme, nuk kanë qenë të vërteta,  
2 por që ai pretendonte që ai ishte shefi i zbulim-  
3 kundërzbulimit. A e kam kuptuar saktë? Është e drejtë kjo,  
4 Dëshmitar?

5 PË. Po, në këtë kohë është thirr kështu.

6 PY. Është një pretendim që ju thoni që e keni -- e keni  
7 konstatuar më pas dhe që nuk është e vërtetë.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Ju lutem çka do me thënë avokati me  
9 këtë që e keni, e keni hetuar ose e keni konstatuar më pas?

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

11 Z. DIXON: [Përkthim]

12 PY. Ju lutem, Dëshmitar, përgjigjuni pyetjes.

13 PË. Është e saktë. Asnjëherë s'kam besu dhe ma vonë e kam  
14 kuptu që besoj që në atë kohë nuk ka qenë e vërtetë për kohën  
15 që ai ka thënë edhe që është thirr me këtë emër.

16 PY. Në rregull. Kur thoni që "është e saktë", që ta kemi  
17 tërësisht të qartë për procesverbal, ju thoni që ajo çfarë  
18 keni thënë ju aty nuk është e vërtetë. Domethënë që ajo çfarë  
19 mësove ti më vonë nuk ishte e vërtetë. A është e saktë kjo?

20 PË. Po unë në atë -- e thashë s'i kam besu që ka qenë e  
21 vërtetë. Edhe ma vonë jam i bindur që s'ka qenë e vërtetë. Po  
22 në atë kohë që ja kam thonë, kam -- çka është deklaruar ai unë  
23 e kam potencu atë.

24 PY. Në rregull. Atëherë, do kalojmë te intervista e UNMIK-ut.  
25 Do kalojmë disa faqe. Tek faqja 4, në përgjigje të pyetjes se

1 kush ishte eprori ose shefi i Sabit Gecit në atë kohë, ju  
2 përgjigjeni:

3 "Mesa di unë ka qenë Kadri Veseli."

4 Nuk ju bëhet më pas një pyetje se si e dini këtë gjë, nga  
5 e keni këtë informacion. Por ju thjesht jepni përgjigjen që:

6 "Mesa di unë ka qenë Kadri Veseli."

7 Në të njëjtën mënyrë edhe ky pretendim këtu nuk është i  
8 vërtetë, apo jo, Dëshmitar?

9 PË. Unë jam thirr, atë ç'ka ka deklaruar z. Geci.

10 PY. Po. Ju thatë që z. Geci e ka pretenduar këtë. Por, ajo ç  
11 po thoni tani është që nuk është deklarata e vërtetë. Z. Kadri  
12 Veseli nuk ka qenë eprori i Kadri -- z. Geci. A është e  
13 vërtetë kjo?

14 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtojmë. Cila është  
15 themelësia e kësaj?

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet  
17 kundërshtimi.

18 Ju lutem përgjigjuni pyetjes në qoftë se keni përgjigje.

19 DËSHMITARI: Unë prapë po them që jam thirr me pretendimet  
20 e z. Geci. Dhe ma vonë jam i bindur që ai nuk ka qenë pjesë  
21 edhe nuk ka [E pakuptueshme] kjo njësit, kjo strukturë nuk ka  
22 ekzistuar në këtë kohë.

23 Z. DIXON: [Përkthim]

24 PY. Nuk ka qenë një strukturë që komandohej nga z. Veseli. A  
25 është e saktë kjo, Dëshmitar?

1 PË. Unë nuk e di, po Sabit Geci është thirr me atë. Edhe unë  
2 besoj që nuk ka qenë përderisa nuk është në evidenca kurrkund  
3 që ai ka qenë.

4 PY. Faleminderit. Tani dua të kaloj tek një tjetër temë, tek  
5 artikulli që i keni dhënë Bota Sot. Sa për ta sqaruar kohën,  
6 në intervistën e UNMIK-ut, pra intervista e UNMIK-ut ka qenë  
7 në vitin 2003. Pra, pasi të ishte bërë publike intervista në  
8 fjalë në Botën Sot, sepse intervista juaj te Bota Sot ka qenë  
9 në 2002. A është e saktë kjo?

10 PË. Besoj që e saktë.

11 PY. Kur u pyetët nga ZPS-ja lidhur me këtë, ju thatë se  
12 kishte pretendime të caktuara, pretendime të rënda të cilat u  
13 ngritën kundër jush tek Bota Sot, në gazetën Bota Sot. Dhe ju  
14 thatë që ishte e nevojshme që ju t'i përgjigjeshit publikisht  
15 këtyre pretendimeve. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

16 PË. Po, e saktë.

17 PY. Kjo e gjitha kishte të bënte me Personin 1 dhe  
18 pretendimet ishin se ju ishit drejtpërsëdrejti i përfshirë në  
19 këtë ngjarje si eprori i z. Geci në zonë, që ju së bashku me  
20 të keni qenë i përfshirë për kryerjen e atyre krimeve. A është  
21 e saktë kjo? A kanë qenë këto pretendime?

22 PË. Po, këto kanë qenë sipas gazetës.

23 PY. Po. Dhe ju e ndjetë të nevojshme t'i kundërpërgjigjeshit  
24 publikisht kësaj.

25 Z. DIXON: [Përkthim] Do kërkoj që të shfaqet në ekran ajo

1 që keni shkruar ju në kundërpërgjigjen tuaj. Nuk do përmend  
2 provën që është pranuar, që është prova P185, por një përkthim  
3 tjetër të këtij dokumenti. Dhe ju mund të komentoni pastaj dhe  
4 krahasojmë dokumentet.

5 Atëherë ju lutem të vendoset në ekran materiali  
6 SPOE0003277 [Sipas përkthimit] deri në 3279.

7 Kjo është një dosje e EULEX-it për këtë çështje ku  
8 përfshihet edhe artikulli Bota Sot që ju e keni parë në shqip.  
9 Është e njëjta gjë në fakt në shqip që është dhe materiali  
10 origjinal, por ka një përkthim të ndryshëm që dua ta shohim  
11 dhe pastaj do t'ju pyes lidhur me këtë.

12 Faqja e parë e artikullit që është marrë nga kompjuteri i  
13 gazetarit. Shohim edhe përkthimin e EULEX-it. Ju lutem  
14 vendoseni në të majtë dhe në të djathtë shqipen, që është  
15 ekzaktësisht si materiali origjinal që është provuar tashmë si  
16 provë gjyqësore dhe ka numrin P185. Faqja 3 në shqip. Në të  
17 majtë. Faleminderit.

18 PY. Dëshmitar, ju lutem shikojeni këtë artikull. Ky është  
19 artikulli në Bota Sot që ka emrin tuaj dhe që ju thoni që  
20 është kundërpërgjigja juaj ndaj këtyre pretendimeve. Saktë?  
21 PË. Po, e saktë.

22 PY. E keni shkruar vetë nga fillimi në fund apo ju ndihmoi  
23 dikush?

24 PË. S'ëm kujtohet.

25 PY. Shohim disa nga formulimet, na thoni nëse ju kujtohen.

1 Është një pjesë në mes që flet për UÇK-në, Shërbimin  
2 Informativ të UÇK-së. E shihni në mes që thotë "E ai është  
3 thirrur si shef i Shërbimit Informativ të UÇK-së". Pas fjalës  
4 "Drenicë", e gjete?

5 Ju lutem na e lexoni ju me zë këtë fjalinë që fillon "E  
6 ai është thirrur si shef i Shërbimit Informativ" dhe do e  
7 marrim nga përkthyeset me gojë. Ju lutem lexojeni me zë  
8 PË. Cilën pjesë? Ku është?

9 PY. Në mes të tekstit është një fjali, "Komandant i Zonës  
10 operative të Drenicës". Është një pikë dhe pas fjalës  
11 "Drenicë", fillon një fjali tjetër që thotë "E ai është  
12 thirrur ...".

13 PËRKTHYESJA: E gjete?

14 DËSHMITARI: Po, e saktë. Po [E pakuptueshme].

15 PËRKTHYESJA: Lexoje me zë këtë të lutem.

16 DËSHMITARI: "E ai është thirrur si shef i Shërbimit të --  
17 si shef i Shërbimit Informativ. Sa për ilustrim" --

18 Ose don me e lexu ma anej?

19 Z. DIXON: [Përkthim]

20 PY. Jo. Duam të shohim si e thanë përkthyesit me gojë këtë  
21 rresht. Po. Pra, "ai është thirrur si shef i Shërbimit  
22 Informativ të UÇK-së". Ky është përkthimi që ka EULEX-i,  
23 ekzaktësisht e njëjta gjë dhe në anglisht.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Dixon, jo "informuese",  
25 "informative".

1 Z. DIXON: [Përkthim] Po, faleminderit. Keni të drejtë.

2 Faleminderit.

3 PY. Në të djathtë shohim që anglishtja thotë:

4 "Dhe ai është thirrur si shef i Shërbimit Informativ të  
5 UÇK-së".

6 Pra, dhe "ai është thirrur si shef i Shërbimit Informativ  
7 të UÇK-së".

8 Mendoj se është e njëjta gjë. Unë thjesht doja ta lexoja  
9 për procesverbal.

10 Tani unë dua t'ju pyes këtë, Dëshmitar, që e sqaruar  
11 përkthimin, pasi e sqaruar pjesën e përkthimit. Kur keni  
12 shkruar ju këtu "është thirrur si shef", ju e keni fjalën këtu  
13 në atë që ju ka thënë vetë z. Geci, se çfarë e thërrisnin atë?  
14 PË. Po, e saktë.

15 PY. Pra, ju morët për të mirëqenë atë që kishte thënë ai,  
16 ndonëse se sot thatë që nuk besonit që ishte e vërtetë, dhe  
17 atë që ju thatë ai ju e hodhët në deklaratë. Pra, pi e ka  
18 pretenduar këtë gjë, ai e ka thënë këtë gjë, dhe unë po  
19 përsëris atë që më ka thënë ai.

20 A është një vlerësim i drejtë ky?

21 PY. Sabit Geci, e thashë edhe më herët, është thirr në këtë  
22 emër të shërbimit dhe këtë e kam potencu disa herë, që edhe në  
23 këtë deklaratë.

24 PY. Po. Dhe ju thjesht keni përsëritur atë që ju kishte thënë  
25 ai, apo jo?

1 PË. Po, e saktë.

2 PY. Dhe ju e përsëritët atë që ju kishte thënë ai, ndonëse ju  
3 e dinit që s'ishte e vërtetë?

4 PË. Asnjëherë s'e kam besu këtë, po s'kam mujt as me e  
5 vërtetu të kundërtën. Por ai është thirr në këtë.

6 PY. A është e saktë që kur t'u desh të bëje këtë  
7 kundërpërgjigje publike në media ishte diçka e volitshme për  
8 ju që ta përsërisnit këtë. Ju konvenonte sepse, domethënë, e  
9 hiqte vëmendjen prej jush, apo jo? E zhvendoste vëmendjen nga  
10 ju?

11 PË. Dhe pse dhe me i thanë -- nuk kam pas arsye ta them një  
12 gjë të tillë, përderisa ai vetë është deklaruar.

13 PY. Po. E di që ai ka pretenduar se është e vërtetë, por ju  
14 vetë thatë që nuk ka qenë e vërtetë, apo jo?

15 PË. Asnjëherë s'i kam besu.

16 PY. Dhe ju nuk e keni besuar as kur ju ka thënë se ai merrte  
17 urdhra prej Shtabit të Përgjithshëm dhe prej askujt tjetër. As  
18 kjo s'ka qenë e vërtetë, apo jo?

19 PË. Ai në këtë kohë ka -- është thirr në emër të SHIK-ut dhe  
20 në emër të Shtabit të Përgjithshëm.

21 PY. Kjo ka qenë diçka që pretendonte ai. Po ne e sqaruar  
22 tashmë që në atë kohë nuk ka ekzistuar SHIK-u. SHIK-u është  
23 krijuar më vonë. Pra, ai nuk po tregonte të vërtetën, apo jo?

24 PË. Është çështje e tijna, por edhe një herë po them, në këtë  
25 rast ai është thirr me këtë, s'i kam besu as atëherë as -- po

1 kështu është thirr edhe --

2 PY. Faleminderit. Përpara se të përfundojmë për pushimin e  
3 drekës, dua të shohim ato ju pyeti ZPS-ja për dënimin tuaj  
4 lidhur me lëndën Drenica II. A është e vërtetë që vendimi  
5 tashmë është i formës së prerë dhe z. Geci nuk është akuzuar  
6 bashkë me ju në atë lëndë? Nuk keni qenë të bashkëakuzuar në  
7 atë lëndë.

8 PË. Po, është e saktë.

9 PY. Ai është akuzuar bashkë me ju në lëndën Drenica I. Ishte  
10 ajo lënda ku pamë edhe dëshminë që ka dhënë mjeku, apo jo?

11 PË. Nuk e di, a ka qenë. Besoj që po.

12 PY. Po. Nëse dëshironi mund ta nxjerrim dokumentin. Po a ju  
13 kujtohet që ju jeni akuzuar bashkë me të në këtë lëndë  
14 gjyqësore. Ju si komandant i zonës dhe ai si një person që  
15 ishte në zonën tuaj.

16 PË. Me [E pakuptueshme] është e saktë.

17 PY. Dhe akuzat lidheshin me vepra penale të kryera në Likoc  
18 në 1998, saktë?

19 PË. Po, e saktë.

20 PY. Këto kanë qenë akuzat, por përfundimisht ju u shfajësuar  
21 edhe për z. Gecin po ashtu u rrëzuan akuzat në atë lëndë  
22 gjyqësore. Saktë?

23 PË. E saktë.

24 PY. A ju kujtohet dëshmia e mjekut që e përmendëm dhe më  
25 herët dhe më vonë u konstatua se dëshmia e tij ishte dëshmi e



1 besueshme?

2 PË. Nuk më kujtohet dëshmia e tij, po ne e diskutuam këtë  
3 çështje.

4 PY. Po. Z. Geci është dënuar, nëse e dini, vetëm për disa  
5 krime të kryera jo në Kosovë, por në Shqipëri, në prill 1999.  
6 E dini këtë?

7 PË. Jo, nuk e di.

8 PY. Megjithatë, nuk ka qenë lënda gjyqësore ku keni qenë dhe  
9 ju i përfshirë. Ai është dënuar për vepra penale jashtë  
10 Kosovës.

11 PË. Okej. Pyetja?

12 PY. Po. Pra ju s'keni qenë i përfshirë në këtë gjykim. S'keni  
13 qenë pjesë e këtij gjykimi ju.

14 PË. Jo, s'kam qenë.

15 PY. Faleminderit, z. Selimi.

16 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kaq pyetje  
17 kisha.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

19 Z. Roberts.

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit.

21 Faleminderit, z. Selimi, unë nuk kam pyetje.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis.

23 Më falni nuk e dija kush do t'i bëjë pyetjet nga ekipi  
24 juaj.

25 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Na jepni një çast, ju

1 lutem. Më jepni një çast ju lutem.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim].

3 Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra:

4 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

5 PY. Mirëdita, z. Selimi. Unë jam znj. Alagendra dhe  
6 përfaqësoj z. Jakup Krasniqi. Edhe unë kam disa pyetje për ju.

7 Në Shënimin Përgatitor numër 2, ju keni thënë se nuk e  
8 keni ditur që Jakup Krasniqi ka qenë anëtar i Shtabit të  
9 Përgjithshëm deri në momentin kur doli publikisht zëdhënës i  
10 UÇK-së. A ju kujtohet t'ja keni thënë këtë Prokurorisë?

11 PË. Po. E saktë.

12 PY. Që ta kuptojmë periudhën kohore, bëhet fjalë për mesin e  
13 qershorit 1998?

14 PË. Besoj që është e saktë.

15 PY. Ditën e hënë, ju treguan disa dokumente që pretendohet se  
16 ishin disa përgjime mes jush dhe Bislime Zyrapit që lidheshin  
17 me rrëmbimin e pesë civilë serbë. A ju kujtohet kjo pjesë?

18 PË. Po.

19 PY. Ju thatë se asnjëherë s'keni biseduar me Bislime Zyrapin  
20 për pesë civilët serbë. Është kjo dëshmia juaj?

21 PË. Po unë thashë që s'më kujtohet një bisedë e tillë.

22 PY. Pra, a është po ashtu e vërtetë që as me Jakup Krasniqin  
23 s'keni pasur ndonjë bisedë me këta pesë civilë serbë?

24 PË. S'ëm kujtohet që kam pas ndonjë bisedë me z. Krasniqi.

25 PY. Një pyetje tjetër. Më 1 shkurt 1999, a keni qenë në

1 Kosovë ju?

2 PË. Po, kam qenë.

3 PY. Po. Nëse ka pasur ndonjë bisedë të pretenduar ku thuhet  
4 se ju keni qenë në Zvicër më 1 shkurt 1999, atëherë i takon që  
5 kjo nuk është e saktë, apo jo?

6 PË. Jo, nuk është e saktë.

7 PY. Faleminderit.

8 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Kaq pyetje kisha.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
10 znj. Alagendra.

11 Ka pyetje plotësuese nga Prokurori?

12 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Ndërkohë po nxjerrim dhe  
13 materialet e reja. Po ndërkohë unë po filloj me materialet që  
14 nuk janë ende në listën e materialeve që ta bëj më të thjeshtë  
15 procesin.

16 Pyetje vijuese nga z. Halling:

17 Z. HALLING: [Përkthim]

18 PY. Dëshmitar, do t'ju bëj disa pyetje lidhur me pyetjet që  
19 ju kanë bërë avokatët mbrojtës dje dhe sot.

20 Do të fillojmë me urdhrin e pretenduar për të arrestuar  
21 Hashim Thaçin, Kadri Veselin, dhe Rexhep Selimin. Kjo është  
22 diskutuar në faqen 25083-25093 të transkriptit provizor.

23 Të lexuan një nga dy paragrafët në shënimin përgatitor  
24 lidhur me këtë çështje, është faqe 25083-25084.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Sidoqoftë unë dua t'ju lexoj

1 paragrafin 14 të këtij shënimi përgatitor.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] E kundërshtoj. Kjo është  
3 sugjestionuese. Ai mund të nxjerrë dëshmi të re në qoftë se  
4 do, po nuk ka nevojë t'i rifreskojë kujtesën sipas rregullës  
5 143.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Po ju ja keni lexuar vetë gjysëm.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet  
8 ankesa. Rrëzohet kundërshtimi - më falni.

9 Z. HALLING: [Përkthim]

10 PY. Dëshmitar, kjo thuhet në shënimin përgatitor lidhur me  
11 këtë urdhër-arrest të pretenduar.

12 "Kur qeshi kur ia treguam fillimisht, dëshmitari", ju  
13 pra, "tha që ky dokument nuk është i vërtetë dhe tha që kjo  
14 është një marrëzi. Dëshmitari nuk e kishte parë asnjëherë këtë  
15 dokument përpara, nuk kishte asnjë nënshkrim dhe dëshmitari  
16 nuk besonte se një urdhër i tillë do të zbatohet ndonjëherë.  
17 Ai tha që nuk është e mundshme që të lëshohet një urdhër-  
18 arrest për arrestuar një person si Rexhep Selimi sepse është  
19 djali i axhës sim."

20 A është e saktë?

21 PË. Po, e saktë.

22 PY. Tani, çfarë pyetjesh ju bëri avokati i z. Veseli për  
23 deklaratën e 2003-shit, që është pjesë e provave gjyqësore dhe  
24 ka marrë numrin P2025. Në 2003-shin, këtë deklaratë a patët  
25 mundësi ta lexonit dhe një herë pasi e dhatë dhe ta

1 nënshkruanit?

2 PË. Besoj që po. Nuk e di, s'më kujtohet po besoj që është si  
3 procedurë që po. Nuk e di.

4 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të nxjerrë në  
5 ekran provën P2025 faqen SITF0031718. Shkojmë në fund të  
6 faqes.

7 PY. Dëshmitar, shihni origjinalin, ju lutem, që në fakt është  
8 anglishtja origjinali. Në fund të faqes a është nënshkrimi  
9 juaj?

10 PË. Saktë.

11 PY. Kjo është pjesë e deklaratës 2003, ku thuhet "E lexuar në  
12 gjuhën amtare të deklaruesit dhe e konfirmuar nga deklaruesi".

13 A ka ndodhur vërtetë?

14 PË. Po, është e saktë që e kam nënshkruar unë edhe që e kam  
15 dhënë këtë deklaratë.

16 PY. Në seancën përgatitore ne ua dhamë mundësinë që ta lexoni  
17 dhe një herë këtë deklaratë, apo jo?

18 PË. Po, e saktë.

19 PY. Dhe të gjitha korrigjimet që bëtë ju, ne i hodhëm në  
20 shënimin përgatitor. Po kjo a është e saktë?

21 PË. Po, e saktë.

22 PY. Kjo ka qenë një nga deklaratat që e konfirmuat dhe të  
23 hënën dhe kur ju pyetëm a do thoshit në njëjtat gjëra nëse do  
24 ju bënim këto pyetje, ju thatë që po. A ju kujtohet kjo?

25 PË. Po.

1 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të vendosë në  
2 ekran provën P2029, dhe konkretisht faqen 125421.

3 PY. Dëshmitar, është vetëm në anglisht kjo, megjithatë kjo  
4 është pjesë e shënimit përgatitor.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Po e vendos në ekran për të gjitha  
6 palët, dhe ju lutem dëgjojeni përmes përkthimit. Për palët që  
7 po na ndjekin, po lexoj paragrafin 8 dhe 9. Është tashmë prova  
8 e marrë me numrin P2029.

9 PY. "I ashtuquajhuri njësitit zbulimit ka qenë aktiv në  
10 qershor të '98-s, por Sabit Geci nuk ka pasur asnjë pozitë në  
11 Zonën Operative të Drenicës. Sabit Geci dhe personat me të i  
12 drejtoheshin vetes ose si njësitit i zbulimit ose SHIK-u. Ju  
13 nuk e keni ditur emrin e babait të Sabit Gecit, por e dinit që  
14 ishte prej Llahës.

15 "Ju njihni një Sabit Geci tjetër që ka qenë në zonën e  
16 Drenicës dhe u bë pjesëtar i Brigadës 114. Ky Sabit Geci i  
17 dytë nuk diskutohet fare në deklarata dhe nuk ka qenë pjesë e  
18 shërbimit të zbulimit."

19 Dëshmitar, a janë korrigjimet këto që ja keni bërë ju  
20 deklaratës tuaj në seancën tonë përgatitore?

21 PË. Vetëm sa i përket Sabit Gecit edhe a ka pas, kjo është  
22 përgjigja. Domethënë, a ka pas edhe Sabit Geci, unë kam thënë  
23 që "po, ka qenë edhe një Sabit Geci tjetër". Sa për sqarim  
24 edhe e kam sqaruar për këtë Sabit Gecin tjetër që ka qenë një  
25 pjesëtar. Po, është e saktë kjo që kam thënë, mirëpo sa i

1 përket ka qenë aktiv në SHIK-un, s'po di, s'jam i sigurt. Unë  
2 mendoj që kam thënë që ka -- që nuk ka qenë aktiv. E gjitha  
3 kjo është e saktë, por nuk e di edhe ma avokatin a është e  
4 saktë apo jo.

5 Z. QERKINI: [Mikrofoni çaktivizuar] i ashtuquajtur.

6 DËSHMITARI: I ashtuquajtur.

7 Z. QERKINI: I ashtuquajtur.

8 DËSHMITARI: Unë mendoj që me -- veç ta analizoj -- veç  
9 mendoj që kam thënë që SHIK-u në këtë periudhë nuk ka qenë  
10 aktiv. E tëra është okej, a po kupton, që kam thënë [E  
11 pakuptueshme].

12 Z. HALLING: [Përkthim] Për procesverbal Avokati Kujdestar  
13 i tha diçka dëshmitarit që nuk u reflektua në procesverbal.

14 DËSHMITARI: Po. Më fal. Unë e pyeta, thashë "E kam thon  
15 që nuk ka qenë aktiv". Këtë. më fal, këtë [E pakuptueshme].

16 Z. HALLING: [Përkthim]

17 PË. Dëshmitar, në deklaratën e 2003-shin për UNMIK-un, është  
18 një fjali këtu. S'kam nevojë ta vendosim në ekran, por po jua  
19 lexoj. Është në faqen e parë. Jeni duke folur këtu për  
20 brigadat në zonën tuaj. Dhe ju keni thënë:

21 "Pasi u formuan këto njësitë e zbulimit që merrnin urdhra  
22 nga Shtabi i Përgjithshëm dhe ne nuk e dinim, ka qenë  
23 domethënë, një njësi zbulimi që merrte urdhra drejtpërsëdrejti  
24 nga Shtabi i Përgjithshëm, por ne nuk e dinim kush operonte në  
25 këtë njësit dhe gjithmonë kemi pasur problematika me këtë

1 njësit.”

2 Tani pyetja ime është kjo: A është e vërtetë që ju  
3 gjithmonë keni pasur problematika me këtë njësit?

4 PË. Nuk e di “gjithmonë” është dhe unë iu kam referu këtij  
5 problematike e cila ka qenë. Domethënë, këtij procesi të cilit  
6 në një rast të caktum ka ndodh. Po a ka qenë problematikë nuk  
7 mund të them ma shumë. Gjithmonë iu kam referu, domethënë,  
8 këtij rastit të cilit e kam pas këtë ankesë dhe jam mundu me e  
9 sqaru.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Ju lutem Sekretarisë t'i kthehemi  
11 faqes së dytë së shënimit përgatitor, dy korrigjimeve. Ju  
12 lutem të mbeten në ekran për hir të pyetjeve të mia.

13 PY. Dëshmitar, sa herë që jua dhamë mundësinë ju nuk e  
14 korrigjuat këtë rresht. Nëse ka qenë një rast i vetëm, pse nuk  
15 e thatë, pse nuk e korrigjuat këtë gjë?

16 PË. Me të thënë të drejtën, meqë ja kam lëshu një sy edhe,  
17 edhe ato mendimet që i kam dhe ato që jam -- i kam gjithmonë  
18 detajet e vogla nuk i kam këqyr edhe s'i kam dhënë rëndësi.  
19 Por në çdo aspekt gjithmonë këtë qëndrim duke e mbajtur dhe  
20 duke thënë që ky Sabit Geci është thirr në këtë periudhë me  
21 këtë emër dhe në këtë institucion. Sa i kam besu as nuk i kam  
22 besu as atëhere edhe tash. Edhe gjithmonë kam thënë që Sabit  
23 Geci nuk ka qenë pjesë e Zonës Operative të Drenicës, ka qenë  
24 një pjesëtar i plagosun dhe që është trajtu me mjekë, lëvizjet  
25 i ka pas të kufizume. Të përgjithshmen gjithmonë e kam dhënë,



1 në detaje të vogla s'i kam -- kjo është e gjitha.

2 PY. Pra, ju mendoni se ky njësit zbulimi që pretendonte, pra  
3 ju thoni që ky njësit zbulimi që thoshte -- ky njësit zbulimi  
4 që thoshte se merrte urdhra nga Shtabi i Përgjithshëm  
5 drejtpërsëdrejti ka qenë thjesht, problematika me të ka qenë  
6 diçka e vogël, e parëndësishme, apo jo?

7 PË. Jo e parëndësishme, por në këtë kohë është thirr me këtë  
8 -- me emër të tyre. Me emër të Shtabit të Përgjithshëm.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do vazhdojmë  
10 pas pushimit të drekës.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

12 Dëshmitar, tani do bëjmë pushimin e drekës. Do rifillojmë  
13 në orën 2.30. Faleminderit që keni qenë me ne deri tani. Mund  
14 të largoheni nga salla e gjyqit.

15 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rifillojmë në  
17 orën 2.30.

18 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.01

19 --- Seanca rifillon në orën 14.30

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

21 Sekretare e seancës, ne do të nxjerrim një urdhër gojor,  
22 kështu që për këtë do ju kërkoja që të kaloni në seancë  
23 private.

24 [Seancë private]

25 [Seancë private teksti i fshirë]

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19 [Seancë e hapur]

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
21 jemi në seancë publike.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

23 Znj. Sekretare, silleni dëshmitarin në sallë.

24 Z. DIXON: [Përkthim] Nëse më lejoni të nderuar Gjykatës,  
25 dua që të përfitoj nga rasti që të kërkoj pranimin si prova

1 gjyqësore të dokumenteve që përdora me dëshmitarin gjatë  
2 marrjes së tij në pyetje.

3 Dokumenti i parë është përkthimi i EULEX-it i artikullit  
4 në Bota Sot që ka numrin 00003277 deri në 000 --

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

6 Z. DIXON: [Përkthim] Atëherë dhe një herë numrat janë  
7 00003277 deri në 00003279.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
9 kundërshtim për këtë dokument?

10 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më lejoni një  
12 çast ju lutem. Dokumenti 00003277 deri në 00003279 do pranohet  
13 si provë gjyqësore dhe do t'i caktohet një emër nga  
14 Sekretaria.

15 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mund t'i  
16 shtohet një prove ekzistuese, prova 185.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra,  
18 dëshironi që t'i shtohet një prove tjetër?

19 Z. DIXON: [Përkthim] Mund t'i shtohet një prove  
20 ekzistuese ose mund të marrë një numër të ri prove. Do të doja  
21 që të kërkoja që t'i shtohet një përkthimi të ZPS-së që është  
22 prova 185, sepse do jetë më e thjeshtë për t'u parë së bashku  
23 me dokumentin ekzistues.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
25 kundërshtim?

1           Z. HALLING: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim. Por dy  
2   versione të ndryshme kërkohen të pranohen si prova gjyqësore  
3   nga dy palë të ndryshme. Në qoftë se mund të bashkohen dy  
4   dokumentet të cilat kërkohen që të pranohen si prova nga dy  
5   palë të ndryshme, nuk është ndonjë problem.

6           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
7   Do t'i shtohet provës P0185.

8           Z. DIXON: [Përkthim] Kërkesa tjetër është që të pranohet  
9   procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarit në lëndën  
10   gjyqësore që e përmenda gjatë marrjes time në pyetje të tij.  
11   Unë diskutova një pjesë të shkurtër të dëshmisë së tij,  
12   megjithatë transkripti është i shkurtër e më konkretisht e kam  
13   fjalën për dokumentin nga faqja 0036447 deri në 00364456.  
14   Besoj, të nderuar Gjykatës, ju kujtohet pyetja që bëra, i bëra  
15   një pyetje dhe ai konfirmoi përgjigjen e dhënë.

16          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
17   kundërshtime?

18          Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo është,  
19   domethënë, deklaratë e dëshmitarit që ka dhënë ndërkohë që ka  
20   dhënë nën betim, nuk është se kemi kundërshtim që të pranohet  
21   ky dokument.

22          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
23   00364447 deri në 00364456 pranohet në provë gjyqësore.

24          SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do  
25   të marrë numrin e provës 2D44. Çfarë klasifikimi t'i vë?

1 Z. DIXON: [Përkthim] Besoj që është dokument publik.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do  
3 riklasifikohet si publik.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk jam i  
5 sigurtë që është e saktë kjo plotësisht. Ne do kërkonim që  
6 aktualisht të klasifikohet si konfidencial dhe të bëhet  
7 rishikimi i klasifikimit më vonë së bashku me provat e tjera.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
9 Është kërkesë e arsyeshme.

10 Z. DIXON: [Përkthim] Në rregull.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
12 Mbaruam me dy dokumentet. Tani mund ta sillni dëshmitarin në  
13 sallë.

14 [Dëshmitari vijon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
16 uleni.

17 Z. Selimi, do të vazhdojmë më tej me pyetjet e  
18 Prokurorit.

19 Z. Prokuror, mund të vazhdoni.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.  
21 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Përpara sesa të shkonim për pushimin  
22 e drekës, po diskutonim lidhur me deklaratën që i keni dhënë  
23 UNMIK-ut në 2003. Për referencë, kemi pjesën përkatëse të  
24 shënimit përgatitor në ekran. Dua t'ju pyes lidhur me një  
25 fjali të dytë që jepet aty.

1 Në 2003 juve ju bëhet kjo pyetje:

2 "Ju lutem na thoni emrat e komandantëve në njësitet e  
3 posaçme, për shembull, në njësitin e inteligjencës?"

4 Dhe ju thoni që:

5 "Komandanti i shërbimit informativ ose zbulim-  
6 kundërzbulimit ishte Kadri Veseli, ndërkohë që komandanti i  
7 njësimit special ka qenë Jahir Demaku."

8 Dëshmitar, ju nuk thatë asnjëherë që nuk keni besuar që  
9 Kadri Veseli nuk ka qenë përgjegjës për atë njësit gjatë  
10 luftës. Pse nuk e korrigjuar këtë pjesë të deklaratës tuaj në  
11 qoftë se vërtetë është kështu?

12 PË. Nuk e di. Por tash po e shoh.

13 PY. Dëshmitar, fjalia që unë sapo ju lexova, këtë fjali të  
14 paktën e keni parë dy herë, sepse ju është lexuar në 2003 dhe  
15 ju është dashur gjithashtu që të lexoni versionin në shqip  
16 gjatë seancës përgatitore. Pse nuk e keni thënë në seancë  
17 përgatitore që ju nuk e besonit këtë?

18 PË. Se nuk m'u ka bë pyetja.

19 PY. Dëshmitar, në këtë sallë gjyqi juve ju bë pyetja në qoftë  
20 se deklarata së bashku me seancën përgatitore dhe korrigjimet  
21 e bëra pasqyron me saktësi atë çka do të thonit në qoftë se do  
22 ju bëheshin të njëjtat pyetje. Pra, pse, juve ju është bërë  
23 pyetja në qoftë se deklarata ka qenë e vërtetë. Pse nuk keni  
24 thënë që deklarata nuk ishte e vërtetë?

25 PË. Më së pari unë e kam këtë vetëm në anglisht këtë. A mund

1 ta shoh në shqip para ekranit?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që ta  
3 mbajë këtë shënimin përgatitor në anglisht, por do i kërkoja  
4 gjithashtu Sekretares që, në mënyrë të tillë që të mund ta  
5 lexojë dëshmitari, të shfaqë përkthimin e provës P202, faqja  
6 1.

7 PY. Mund ta bëjmë këtë, Dëshmitar. Për një çast do shfaqet në  
8 ekran dhe mund ta lexoni.

9 PË. Ju faleminderit.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Të kalojmë në fund të faqes.

11 PY. Atëherë pyetja që po ju bëja unë është kjo fjali:

12 "Ju lutem më thoni emrat e komandantëve të njësisë  
13 speciale dhe njësisë së inteligjencës?

14 "PË. Komandanti i njësisë speciale ishte Jahir Demaku  
15 dhe komandant i njësisë së inteligjencës ishte Kadri Veseli."

16 Dëshmitar, a është e saktë kjo?

17 PË. Unë -- po, po e shoh tash. Domethënë, kjo ka qenë në  
18 kuadër të asajna që Kadri Veseli ka qenë më vonë si shef i G2  
19 apo i inteligjencës. Në këtë aspekt e kam thënë. Jo, komandant  
20 i njësisë. Komandant i njësisë mendoj që është gabim. Por si  
21 pjesëtar ose si i njësisë për inteligjencë ose si G2, në këtë  
22 aspekt unë mendoj që e kam thënë.

23 PY. Dëshmitar, a është dëshmia juaj që përgjigja juaj këtu  
24 është që ju keni dhënë përgjigje që Kadri Veseli ishte shefi i  
25 inteligjencës në përgjithësi, këtë po thoni?



1 PË. Unë po mendoj që ka qenë gabim se, në këtë periudhë, si  
2 shef i inteligjencës ndoshta veç jam bazu në ato që ka thënë  
3 z. Geci.

4 PY. Në qoftë se ishte gabim, pse nuk e korrigjuat këtë gabim  
5 kur ju dha mundësia që të bënit korrigjimet përkatëse një javë  
6 përpara dhe javën e fundit, përpara një jave dhe përpara dy  
7 javësh?

8 PË. Është gabim i jem që s'e kam lexu këtë detaj.

9 PY. Ju e keni konsideruar faktin që keni thënë që Kadri  
10 Veseli ka qenë komandant i njësisë së inteligjencës si një  
11 hollësi, si një detaj të vogël?

12 PË. Është gabim i imi që s'e kam pa këtë në fund, por me  
13 siguri edhe këtu kur ju kam referu, ju kam referu për z. Geci  
14 i cili ça ka thënë në atë periudhë.

15 PY. Të shohim një tjetër dokument.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që të  
17 kalojmë në faqen e dytë.

18 PY. Këtu ju bëhet po ashtu një pyetje tjetër, është pyetje që  
19 ju është bërë në 2003:

20 "Kur keni përmendur persona të ndryshëm që bënin këto  
21 gjëra ose gjëra si këto" dhe kjo lidhet, për shembull, me  
22 Personin 1, pyetja është "Kur ju përmendni njerëz krejt të  
23 ndryshëm që bënin gjëra si këto, a i referoheni Sabit Gecit  
24 dhe shokëve të tij?"

25 Ju përgjigjeni:

1 "Nuk e di nëse ishte Sabiti ai që i bënte këto gjëra, por  
2 Kadri Veseli ishte komandant i SHIK-ut dhe kishte dhe grupe të  
3 tjera që ne nuk i njohim që vepronin në zonë, por unë  
4 gjithashtu kam dijeni se disa nga ushtarët tanë kishin  
5 probleme me këto grupe. Më e mira do të ishte po të pyesnit  
6 Kadri Veselin sepse ai e njeh më mirë strukturën e njësisë së  
7 vet dhe ku ishin vendosur ata."

8 Dëshmitar, ju i thatë avokatit të Veselit që nuk keni pas  
9 njohuri për ekzistencën e njësiteve, njërive. Ndërkohë që këtu  
10 ju po flisni për ekzistencën e kësaj njësie, a nuk është  
11 kështu?

12 PË. Është fjala prapë për një rastin e caktum dhe për si u  
13 shpreh z. Geci në këtë rast. Mirëpo sa i përket z. Veseli  
14 është, për mendimin tem, është gabim. Ka qenë fakt, domethënë,  
15 që në Shtabin e Përgjithshëm por si G2 apo si njësi  
16 inteligjence apo nuk i kam dit në këtë kohë se çfarë strukture  
17 ka pas. Por gjithmonë në qoftë se iu kam referu, ju kam referu  
18 ma vonë nga ajo që z. Veseli ka qenë në Shtabin e Përgjithshëm  
19 si pjesëtar i G2 apo diçka e tillë, po asnjëherë s'e kam dit  
20 saktë çka. Po për këtë periudhë, iu kam referu gjithmonë ato  
21 çka ka thënë z. Geci.

22 PY. Dëshmitar edhe kjo vë në dyshim ose ngre pyetjen që pse  
23 nuk e keni korrigjuar këtë paragraf gjatë seancës përgatitore  
24 ose përpara sesa të fillonit të jepnit dëshminë. Pse nuk e  
25 keni bërë këtë korrigjim, Dëshmitar?

1 PË. Të thashë që s'e kam lexu fare. Veç e kemi lëshu një sy  
2 kështu që ato gjithmonë i kam -- duke mendu që i kam ato të  
3 kjarta për çka ne do të flasim.

4 PY. Dëshmitar, ju po thoni që e keni kuptuar që Kadri Veseli  
5 ka qenë përgjegjës për G2, a e kam saktë që në rastin e  
6 ngjarjeve që ju po përmendni këtu e keni fjalën për qershorin  
7 e vitit 1998, kjo është periudha kohore?

8 PË. Jo, po flas në periudhën e mëvonshme kur unë e kam -- kur  
9 ka qenë publike që e trajtuam dhe më herët. Po në këtë kohë ju  
10 kam referu gjithmonë atë çka ka thënë, domethënë, z. Geci.

11 PY. Dëshmitar, ju në shënimin përgatitor që është në ekran  
12 thoni që "i ashtuquajtimi njësi inteligjence ka qenë aktive në  
13 qershor të 1998". A po thoni ju që në këtë pikë kur keni dhënë  
14 dëshminë për UNMIK-un ju e keni kaluar këtë periudhë kohore  
15 dhe pastaj keni vazhduar me një periudhë më të vonë?

16 Z. DIXON: [Përkthim] Ju lutem, a mund ta nxirrni  
17 dëshmitarin nga salla, sepse dua që të bëjë një koment po nuk  
18 dua të jetë i pranishëm dëshmitari.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nxirreni nga  
20 salla dëshmitarin, ju lutem.

21 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
23 vazhdoni.

24 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, sigurisht që  
25 nuk kemi kundërshtim që të pyetet dëshmitari që pse nuk ka

1 korrigjuar diçka, megjithatë unë kundërshtoj që të përmenden  
2 paragrafët 8 dhe 9 si vende ku duhet të bëheshin korrigjimet,  
3 sepse nuk është e qartë që kjo është pyetja që i është bërë  
4 dëshmitarit. Pra, këto duken sikur janë përgjigje të pyetjeve  
5 të bëra nga z. Halling, pra, për shembull, Prokurori ka pyetur  
6 "Kush është Sabit Geci?", tjerë e tjerë. Domethënë, nuk është  
7 se Prokurori ka thënë që "Të kalojmë rresht pas rreshti çdo  
8 lloj gjëje që keni thënë".

9 Kështu që mendojmë dhe parashtrojmë që është e gabuar kjo  
10 qasje me dëshmitarin sepse, domethënë, dëshmitarit i janë bërë  
11 pyetje konkrete, specifike nga z. Halling. Plus që ne nuk kemi  
12 një procesverbal, nuk kemi procesverbal për bisedën e ndodhur  
13 ndërmjet të dyve.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]  
15 Kundërshtohet. Rrëzohet kundërshtimi i bërë prej jush.

16 Ju lutem silleni dhe një herë dëshmitarin në sallë.

17 Në qoftë se keni pyetje mund t'ia bëni pyetjet në  
18 momentin kur t'ju japim fjalën pasi të përfundojë Prokuroria.

19 [Dëshmitari vijon dëshminë]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
21 vazhdoni, z. Halling.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

23 PY. Mua m'u la mundësia, m'u dha leje që të përdor, ta bëj  
24 dhe një herë pyetjen që ju bëra pak më herët. Po jua përsëris  
25 edhe një herë.

1           Juve thoni në Shënimin Përgatitor 2 që unë jua lexova pak  
2 më herët që ju e dinit që shef i shërbimit të inteligjencës ka  
3 qenë Kadri Veseli nga qershori i vitit 1998. Ju çfarë po thoni  
4 që në deklaratën e UNMIK-ut e keni kaluar periudhën e  
5 qershorit që 1998 dhe keni vazhduar me një periudhë të  
6 mëvonshme?

7 PË. Jo, jo. Unë po them që ju kam referu atë që ka thënë z.  
8 Geci në këtë, domethënë, në këtë proces dhe as nuk kam pas  
9 mundësi ta vërtetoj as ta -- nuk jam merr më me këtë çështje.  
10 Kam pas çështjet e mia, domethënë, në zonë. Dhe sa i përket z.  
11 Kadri Veseli s'e kam taku asnjëherë dhe s'e kam -- unë ju kam  
12 referu gjithmonë ajo çka ka thënë z. Geci. Besoj që kështu.

13 PY. Dëshmitar, Avokatit të z. Veseli ju i thatë që nuk jeni i  
14 bindur që ka pas një njësi të tillë në këtë kohë. Kur nuk u  
15 bindët, domethënë, në çfarë pike nuk ishit i bindur, kur  
16 ndodhi që të mos ishit plotësisht i bindur?

17 PË. Edhe për këtë rast i cili ka qenë i izoluar, kur unë kam  
18 pyet për rastin e caktum, unë nuk kam qenë i bindur që z. Geci  
19 po thotë atë të vërtetën. Po megjithatë më nuk jam merr me të  
20 për arsye të vet situatës dhe kohës të cilat unë kam qenë. Po  
21 megjithatë unë kam thanë atë çka ka deklaruar ai.

22 PY. A mund të na shpjegoni se pse nuk i keni thënë UNMIK-ut  
23 në 2003 që nuk keni qenë i bindur që Kadri Veseli ka qenë  
24 përgjegjës për një njësi të tillë, pse nuk ia keni thënë  
25 UNMIK-ut këtë?

1 PË. Po s'ma kanë bë pyetjen.

2 PY. A mund të na shpjegoni se pse përpara një jave në seancë  
3 përgatitore kur patët mundësinë që të sqaronit ose të bënit  
4 korrigjime tek kjo pjesë, ju nuk thatë që nuk ishit i bindur  
5 që Kadri Veseli ka qenë përgjegjës për këtë njësi?

6 PË. Po as ju s'ma keni bë këtë pyetje direkte.

7 PY. Të hënën kur ju pyetën në qoftë se të gjithë deklaratat  
8 tuaja janë të sakta, duke marrë parasysh korrigjimet që ju  
9 keni bërë në seancë përgatitore, pse thatë jo, pse thatë po,  
10 domethënë, ndërkohë që nuk ishit i bindur me këtë, pse thatë  
11 që --

12 PË. Me pyetjen konkrete sikur tash? A keni qenë i bindur se  
13 s'ma keni bë pyetjen? Por ajo është bindja jeme e cila për  
14 këtë periudhë nuk kam pas njohuri të tilla ma të shumta. Por  
15 sa i përket kësaj nuk i kam detajet, nuk i kam këqyrë  
16 deklaratës fort. Pyetjen konkrete as ju s'ma keni drejtu  
17 direkt.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Do vazhdoj më tej pasi dëshmia e  
19 mëparshme e dëshmitarit është e qartë.

20 PY. Tani do të kalojmë tek disa pika të fundit. Një prej  
21 temave që dua të diskutoj ka të bëjë me Adem Demaçin. Mbrojtja  
22 e Thaçit ju pyeti lidhur me ndikimin e Adem Demaçit gjatë  
23 kohës së Rambujesë dhe, në veçanti, në qoftë se ai kishte  
24 kompetencë për udhëheqjen politike të UÇK-së. Ju thatë që nuk  
25 e dini. Për procesverbal kjo është thënë në faqet 25068 deri

1 në 25069.

2 Pyetja e parë është kjo: Ndërkohë që zëdhënësi i UÇK-së  
3 ka qenë Jakup Krasniqi, a mendoni që Jakup Krasniqi ka qenë më  
4 në gjendje ose i pozicionuar më mirë për t'ju përgjigjur kësaj  
5 pyetjeje ose për të pasur njohuri rreth kësaj pyetjeje?

6 PË. Nuk e di. Megjithatë mund të them përse z. Demaçi ka qenë  
7 një ndër figurat ma atdhetare edhe një respekt ka gëzu jo  
8 vetëm nga unë personalisht, por të gjithë shqiptarët e Kosovës  
9 edhe e ka pas respektin më të madhin. Sa i përket a ka qenë në  
10 dijeni apo nuk kanë qenë në dijeni këta mes veti, unë nuk mund  
11 ta them.

12 PY. Pyetja ime nuk ka të bëjë me reputacionin ose me emrin e  
13 mirë të z. Demaçi, por konkretisht ka të bëjë në qoftë se ai  
14 ka qenë përfaqësuesi i përgjithshëm politik i UÇK-së. A mund  
15 të thoni në qoftë se Jakup Krasniqi ka qenë në një pozicion më  
16 të mirë ose më të keq për ta ditur këtë gjë?

17 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Nga ta dijë dëshmitari  
18 këtë, është në gjendje dëshmitari që t'i përgjigjet një pyetje  
19 të tillë?

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo është  
21 pyetja që bëri ai.

22 Në qoftë se e keni përgjigjen e pyetjes, ju lutem  
23 përgjigjuni pyetjes, Dëshmitar.

24 DËSHMITARI: Nuk e di si zëdhënës. Mirëpo në -- si  
25 zëdhënës po ta shohësh në pikëpamje duhet të ketë qenë më i

1 ulët, kurrsesi në pozitë.

2 PY. Të shohim atë çka ka thënë Jakup Krasniqi.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Për këtë do i kërkoja Sekretares  
4 që të paraqesë në ekran dokumentin SPOE00230638 dhe në  
5 anglisht, domethënë, dokumenti i parë ishte në shqip, ndërkohë  
6 që në anglisht do ju lutesha që të kalonit tek faqja 3 e  
7 transkriptit.

8 PY. Dëshmitar, dokumenti që do shikoni në ekran që nuk e keni  
9 parë gjatë seancës përgatitore. Por sa për kontekst, është  
10 intervistë e dhënë nga Jakup Krasniqi më 4 mars 1999. Ai thotë  
11 si më poshtë:

12 "Në fakt, Adem Demaçi nuk ka qenë asnjëherë përfaqësuesi  
13 i përgjithshëm politik i UÇK-së. Përgjegjësitë e tij ishin që  
14 të krijonin këto institucione që po i krijojmë ne tani. Nuk ka  
15 pasur asnjë zëvendësim individual të askujt që mund të  
16 zëvendësonte punën kolektive të Shtabit të Përgjithshëm apo  
17 Drejtorinë Politike të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së."

18 A keni ndonjë arsye për të kontestuar atë çfarë ka thënë  
19 z. Krasniqi sipas kësaj pjese që ju lexova?

20 PË. Unë mund të them që në këtë kohë, z. Demaçi e ka qenë  
21 figurë publike, ka qenë përfaqësues politik i Ushtrisë  
22 Çlirimtare të Kosovë dhe ka pas zyrën dhe adresën në qendër të  
23 Prishtinës. Sa i përket, çka ka thënë z. Krasniqi, nuk e di dhe  
24 nuk mund ta komentoj.

25 PY. Në rregull.



1           Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoj Sekretares të paraqesë  
2 në ekran dokumentin P1883, konkretisht në faqen SPOE00131856.  
3 PY. Dëshmitar, përsëri për kontekst, dua t'ju them që kjo  
4 është një intervistë me Rexhep Selimin. Rexhep Selimi këtu  
5 flet për mënyrën sesi UÇK-ja në fund ndahet nga Adem Demaçi  
6 pas kthimit nga konferenca e Rambujesë. Do ju lexoj një pjesë  
7 të këtij dokumenti, Dëshmitar. Atëherë këtu thuhet që:

8           "Shkurorëzimi përfundimtar i UÇK-së me Demaçin ndodhi në  
9 malet e Berishës, apo jo? Delegacioni kthehet nga Rambujeja  
10 ditën e enjte, ndërsa Demaçi takohet me Shtabin e Përgjithshëm  
11 ditën e shtunë. Si ka rrjedhur ai takim?"

12           Përgjigja është si më poshtë nga z. Selimi:

13           "Demaçi aty e lëshoi mbledhjen e Shtabit të Përgjithshëm.  
14 Insistonte që marrëveshja të mos nënshkruhej asesi dhe tentoi  
15 ta përdorte ndikimin e vet në komanda të zonave, por nuk iu  
16 mor parasysh nga komandantët e zonave, kështu që një farë  
17 mënyre vetë heshtja e tij prej asaj kohe deri më tash tregon  
18 një zhgënjim ose një dështim të tij. Një heshtje, një  
19 moskyçje, një mosangazhim i tij në proces është i  
20 pajustificueshëm dhe sadopak lë një zbrazëtim në jetën e tij  
21 shumë të frytshme si simbol i rezistencës kombëtare."

22           A është përshkrimi që jep Rexhep Selimi lidhur me Adem  
23 Demaçin sa i takon rolit të tij i saktë, Dëshmitar, pra,  
24 domethënë, që Adem Demaçi nuk ishte më përfaqësuesi i  
25 përgjithshëm pas kthimit nga Rambujeja, a është e saktë kjo?

1 PË. Çka mund të them unë që z. Demaçi ka qenë përfaqësues  
2 politik deri në kohën kur ka ardhun, kur janë kthyer dhe  
3 pjesëtarët e Rambujesë dhe unë ashtu e kam vlerësu gjithmonë.  
4 Kurse për sa i përket shkrimit, ndoshta kjo dihet më mirë nga  
5 vetë Shtabi i Përgjithshëm bisedat të cilat kanë qenë. Por për  
6 mu, ka qenë një ndër figurat kryesore në Prishtinë. Z. Demaçi  
7 që ka qenë publik edhe i ka pas deklaratat publike. Edhe e kam  
8 taku disa herë në Zonën Operative të Drenicës.

9 PY. Unë këtë e kuptoj. Po është një fjali konkrete këtu e  
10 Rexhep Selimit që mbase ti ke mundësi ta komentosh. Ku thotë:

11 "Ai insistonte që marrëveshja të mos nënshkruhej asesi  
12 dhe tentoi ta përdorte ndikimin e vet në komanda të zonave,  
13 por nuk ju morë parasysh nga komandantët e zonave, kështu që  
14 në një farë mënyre vetë heshtja, pra, e asaj kohe deri më tash  
15 tregon një zhgënjim ose një dështim të tij."

16 Përshkrimi që i bën z. Rexhep Selimi kësaj ngjarjeje a  
17 është i saktë apo jo?

18 PË. Prapë ndoshta mundet diçka me pas saktësi, por unë e di  
19 që mbas nënshkrimit të Rambujesë nuk kemi pas kontakte më me  
20 z. Demaçi, vetëm përmes telefonit një herë apo dy herë. Ai po  
21 më duket në këtë kohë ka qenë në Slloveni apo dikun. E di që  
22 kam komuniku me të me telefon. Por sa i përket pozitës tina të  
23 më vonshme, nuk e di.

24 PY. Sa i takon pozitës së komandantit të përgjithshëm, Adem  
25 Demaçi a ka pasur ndonjë ndikim në përzgjedhjen tuaj si

1 komandant i përgjithshëm?

2 PË. Jo, nuk ka pas.

3 PY. Faleminderit.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Mund të hiqet dokumenti nga  
5 ekrani.

6 PY. Gjëja e fundit për të cilën dua t'ju pyes lidhet me këtë:  
7 Mbrojtja e z. Thaçi, po edhe e z. Veseli, ju bëri disa pyetje,  
8 ju bënë disa pyetje lidhur me takimet që i paraprinë postit të  
9 komandantit të përgjithshëm përfshirë dhe procesverbalin e  
10 takimeve ku flitej për një puç të mundshëm.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Kjo është përmendur në transkript  
12 në faqen 2505335507, është përmendur edhe sot.

13 Ka dalë shumë shpesh në ekran prova 182. Ju lutem të  
14 vendoset sërish në ekran e njëjta provë dhe të shohim faqen  
15 SPOE00226405.

16 PY. Dua të shohim edhe një herë procesverbalin apo shënimet e  
17 takimit të 6 shkurtit 1999. Ju kujtohen pyetjet për këtë  
18 mbledhje? Dëshmitar, na intereson kjo faqja ku Samia thotë:

19 "Rexhep Selimi, Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli janë  
20 përgjegjës për situatën që jemi në këtë momente."

21 Për t'ju orientuar për kontekst.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër.

23 PY. Këtë faqe ua treguan vetëm për faktin se përmendet emri i  
24 "Syla" dhe ju kanë thënë që kjo ka qenë fillimi i ndërhyrjes  
25 suaj, por, në fakt, ndërhyrja juaj nuk ka qenë, nuk është

1 thënë çfarë keni thënë:

2 "Në Zonën Operative të Drenicës kemi vendosur ata që kanë  
3 luftuar me trimëri qysh nga fillimi.

4 "Hashim Thaçi dhe Dhjetëshi kanë kontribuar në luftë që  
5 nga fillimi.

6 "Dhjetëshi është një nga ata që ka rrezikuar më shumë  
7 gjatë luftës."

8 Pra, kjo që thuhet në këtë shënim a është vërtetë, a vlen  
9 vërtetë për këta tre persona se çfarë rëndësie kishin këta tre  
10 persona për luftën?

11 PË. Jo, nuk e besoj. Nuk është, e para, nuk është -- nuk e di  
12 ka është ky shkrim. Dhe nuk e di që është mbajt një takim i  
13 tillë dhe që është diskutu diçka e tillë.

14 PY. Dëshmitar, kjo është interesante. Po nuk është tamam  
15 përgjigja e pyetjes time. Pyetja ime është kjo: Për pozicionin  
16 që keni pasur ju, qëndrimin tuaj, ky ka qenë qëndrimi juaj, a  
17 është e saktë kjo që është pasqyruar këtu sa u takon këtyre  
18 tre personave dhe rëndësia që kanë pasur këta për luftën?

19 PË. Nuk është qëndrimi. Se nuk e di ma së pari a është e  
20 saktë kjo që kanë shkru këtu. Se nuk po më kujtohet ndonjë  
21 takim të tillë që është diskutu diçka e tillë.

22 PY. Shohim faqen tjetër. Edhe këtë faqe e keni parë. Është  
23 përmendur në transkript në faqen T25059-25060. Edhe ju keni  
24 thënë:

25 "Derisa të marrim emërimet e reja, nuk do t'i përgjigjem

1 për asnjë kërkesë, as nuk do t'ju raportoj edhe posti im si  
2 komandant i zonës operative do të kontestohet.

3 "Vetëm atëherë do t'i kryej detyrat që më cakton Shtabi i  
4 Përgjithshëm dhe nuk do të kontestoj asnjë urdhër."

5 Dëshmitar, kemi folur për këto gjatë seancës përgatitore.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Për këtë do i lutesha ju,  
7 Gjykatës, të shkonim në paragrafin e shënimit përgatitor që  
8 është paragrafi 45 dhe lidhet me këtë pikë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

10 Z. HALLING: [Përkthim]

11 PY. Dëshmitar, kur e patë këtë gjatë seancës përgatitore ju  
12 thatë kështu:

13 "Asnjëherë nuk keni thënë që do të kontestoni urdhrat e  
14 personave që përshkruhen këtu".

15 Kështu keni thënë ju, në mënyrën që përshkruhet këtu - më  
16 falni - a është e saktë kjo?

17 PË. Po, është e saktë. Unë asnjëherë s'më kujtohet që në  
18 takim të tillë është diskutu një diçka e tillë. Dhe për mua  
19 është e saktë. Unë asnjëherë s'e kam kontestu. Unë kam pas  
20 vërejtje ndoshta te persona të caktum që kanë qenë me pozita,  
21 por nuk besoj që e kam thënë një diçka të tillë.

22 PY. Faleminderit.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Tani shohim në ekran një video me  
24 numër 068933B, Pjesa 4 dhe të shohim në 00:54:55. Dhe vendosni  
25 dhe përkthimin në anglisht përbri videos, ju lutem, me numër

1 P761.4, të fillojmë në faqen 13.

2 Të nderuar Gjykatës, kjo është intervista që i ka dhënë  
3 Rexhep Selimi ZPS-së. Nuk mendojmë që duhet ta bëjmë në seancë  
4 private, gjykojmë që është normale ta bëjmë dhe në seancë  
5 publike, ta shohim dhe në seancë publike këtë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Presim që të vendoset videoja në  
8 ekran.

9 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës  
10 këshillohen]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Video mund të  
12 përcillet, po.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë kur ta keni gati videon ju  
14 lutem fillojmë në 00:42:55 deri në 00:44:44.

15 PY. Dëshmitar, kjo është një video, është intervista që  
16 Rexhep Selimi ka dhënë për ZPS-në dhe ka qenë e incizuar. Dhe  
17 këtu do të flasë edhe për ju ai këtu edhe për rolin që keni  
18 pasur ju si komandant i përgjithshëm, ju lutem, ndiqeni dhe më  
19 parashtrim do t'ju bëj disa pyetje.

20 [Luhet videoincizimi]

21 "E kuptova drejt kur thatë se ju personalisht keni bërë  
22 propozimin që Azem Sylaj të hiqej -- a e kuptova saktë që ju  
23 thatë që ju, ju vetë, e keni bërë propozimin që Azem Sylaj të  
24 hiqej, të shkarkohej?

25 "Jo, kështu tamam. Prandaj desha të them, unë i rashë nga

1 ana tjetër propozimit.

2 "Çdo të thoni me këtë?

3 "Unë kërkova nga komandantët e zonave që ata të vendosin  
4 në atë takim pa dalë jashtë fare, pa u shpërnda domethënë, se  
5 kush do të jetë komandanti juaj. Dhe njëri, komandanti do të  
6 jetë njëri nga ju. Mblidhuni, vendosni bashkë. Kështu kemi  
7 vepruar atë ditë. E kanë propozuar njërin nga ata, Sylejman  
8 Selimin, si komandant i përgjithshëm. Dhe atë ditë është  
9 vendosë që Sylejman Selimi të jetë komandant i përgjithshëm me  
10 propozimin e komandantëve të zonave. Normalisht nuk kam mundur  
11 që atë natë të formalizohet. Në mbledhjen e ardhshme të  
12 Shtabit të Përgjithshëm, ata që kemi qenë - s'më kujtohet kush  
13 kemi qenë aty - e kemi pranuar propozimin e tyre si vendim."

14 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

15 PY. Dëshmitar, kjo që thotë Rexhep Selimi këtu për mënyrën  
16 sesi u bëtë ju komandant i përgjithshëm a është një përshkrim  
17 i saktë?

18 PË. Po, i saktë.

19 PY. Një temë tjetër.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Ju lutem të vendosim në ekran  
21 materialin DHT03883 deri në DHT03894-ET.

22 PY. Dëshmitar, këtë na e ka dhënë Mbrojtja e Thaçit në  
23 anglisht, po do jua shpjegoj unë çfarë është dhe do ju lexoj  
24 pjesën që më intereson mua. Thuhet:

25 "Kosova, në luftë dhe Paqe, Shkëlzen Gashi

1 "Sylejman Selimi."

2 A ju kujtohet t'i keni dhënë ndonjë intervistë Shkëlzen  
3 Gashit në 2005?

4 PË. Nuk më kujtohet. Besoj që po. A mundet me qit në shqip?

5 PY. Nuk e kemi në shqip këtë version, po më intereson, më  
6 interesojnë gjëra shumë të vogla.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Shkojmë në faqen e dytë.

8 PY. Unë do t'ju lexoj pyetjen dhe përgjigjen këtu.

9 PË. Okej.

10 PY. Shkojmë më poshtë është me pjesën ku thotë, pyetja është  
11 kjo:

12 "Kush janë këta komandantët që nuk pajtoheshin me  
13 Rambujenë?"

14 Dhe ju i jeni përgjigjur kështu:

15 "Të gjithë komandantët e zonave operative të UÇK-së ishin  
16 kundër. Si komandantë zone, ne ishim kundër saj dhe çdo herë  
17 që komunikonim mes vedi, e ngrinim si problem përmbajtjen e  
18 marrëveshjes së Rambujesë. Në një mënyrë apo në një tjetër, ne  
19 u bëmë trysni atyre të mos e nënshkruanin këtë marrëveshje.

20 "Veç trysnisë a planifikuat edhe një puç?"

21 Jeni përgjigjur:

22 "Nuk është e vërtetë. Ne nuk planifikuam një puç."

23 Dëshmitar, kjo që keni thënë këtu a është e saktë?

24 PË. Po, e saktë.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] A mund ta lexoni të gjithë



1 paragrafin, ju lutem?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Patjetër. Nuk dëgjuam përgjigjen e  
3 dëshmitarit.

4 PY. Ju lutem edhe një herë, Dëshmitar?

5 PË. Po, është e saktë.

6 PY. Përfundojmë atëherë:

7 "Si komandantë zone të UÇK-së, kishim kontakte shumë të  
8 mira me përfaqësuesin politik të përgjithshëm të UÇK-së, Adem  
9 Demaçin dhe zyrën e tij në përgjithësi. U kërkua disa herë të  
10 mësonim kush ishte komandanti i përgjithshëm i UÇK-së. Na  
11 thanë" - dhe kalojmë në faqen tjetër, ju lutem - "na thanë se  
12 ekzistonte një ... komandant i përgjithshëm, por nuk e dinim  
13 kush ishte. Çdo herë në të gjitha takimet e komandantëve të  
14 zonave të UÇK-së bëhej pyetja të mësonim kush ishte komandanti  
15 i përgjithshëm i UÇK-së, kush ishte personi që po na drejtonte  
16 ne."

17 Pra, besoj që kjo është diçka që ia keni thënë në fakt  
18 edhe Mbrojtjes së z. Thaçi gjatë pyetjeve të veta, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Për komandantin e përgjithshëm?

21 PË. Po, e saktë.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Tani, shohim materialin DHT03890,  
23 në fund të faqes dhe më pas kalojmë në faqen tjetër 3891.

24 PY. Është po ashtu një paragraf që dua ta lexoj. Vazhdon  
25 intervistuesi:

1 "Nuk kam dilema që marrëveshja e Rambujesë është  
2 katastrofike, po kam pikëpyetje nëse do ta vazhdonim luftën  
3 dhe ta fitonim atë."

4 Kjo ka qenë pyetja. Ju u përgjigjët:

5 "Lufta do të vazhdonte. Unë isha kundër shkuarjes në  
6 konferencën e Rambujesë dhe nënshkrimit të marrëveshjes së  
7 Rambujesë, por për hir të shoqërisë, nuk doja që ta prishnim.  
8 T'u vijë turp atyre që thonë që ne donim të bënim një puç. Unë  
9 vërtetë do të përballesha me ata që kanë thënë që ne kishim  
10 planifikuar një puç. Absolutisht nuk ka ekzistuar asnjë puç."

11 A e keni thënë diçka të ngjashme, Dëshmitar?

12 PË. Po.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

15 Gjykatësi Barthe.

16 Pyetje nga Trupi Gjykues:

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëdita, z. Selimi.

18 PË. Mirëdita.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Trupi Gjykues po ashtu ka  
20 disa pyetje për ju për të sqaruar disa aspekte që nuk i kemi  
21 tërësisht të qarta, pyetjet e mia lidhen kryesisht me  
22 informacionet që keni dhënë gjatë seancës përgatitore me ZPS-  
23 në dhe t'i krahasojmë me ato që keni thënë në sallën e gjyqit  
24 këto dy-tri ditë.

25 Fillojmë me Shënimin Përgatitor 1, paragrafi 6. Thuhet si

1 në vijim. Po ua lexoj paragrafin, po ua lexoj në anglisht  
2 sepse shënimet përgatitore nuk janë të përkthyer në shqip. Ju  
3 lutem dëgjoni me vëmendje:

4 "Menjëherë pas përzgjedhjes së Dëshmitarit 04290 si  
5 komandant i përgjithshëm, ai u kthye në zonën e Drenicës dhe  
6 qëndroi me të njëjtët persona që kishte qëndruar dhe më  
7 përpara. W04290 nuk mund t'i ushtronte funksionet e tij si  
8 komandant i përgjithshëm derisa të kthehej delegacioni i  
9 Rambujesë sepse W04290 duhej të komunikonte me ta  
10 paraprakisht. Është e paqartë, ishte e paqartë se në ç'fazë  
11 ishin negociatat në atë kohë dhe personat nuk ishin të  
12 informuar."

13 Tani, z. Selimi, pyetja ime e parë është kjo: A mund të  
14 na e shpjegoni dhe një herë pse nuk mund të ushtronit ju  
15 funksionet si komandant i përgjithshëm dhe pse duhet të  
16 komunikoni me anëtarët delegacionit paraprakisht para  
17 ushtrimit të detyrave?

18 PË. Mund ta shpjegoj në një formë më të përgjithshme. Pas  
19 zgjedhjes time si komandant i Shtabit të Përgjithshëm,  
20 delegacioni, shumica e anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm  
21 ishin dhe në kuadër të delegacionit të Rambujesë. Dhe unë  
22 fizikisht isha në Drenicë prapë me ata njerëz të cilët  
23 qëndroja në Drenicë. Dhe, faktikisht, ne e pritshim edhe çfarë  
24 po ndodhë në Rambuje. Kjo është, kjo mendoj që është ajo çka  
25 kam dashtë me thënë.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, anëtarët e  
2 delegacionit, delegatët e Rambujesë ishin të informuar apo  
3 ishin të painformuar apo më saktë desha të thoja, a kanë qenë  
4 të përfshirë delegatët në emërimin tuaj, apo jo?

5 PË. Jo, pjesa e delegacionit nuk kanë qenë të përfshirë. Ka  
6 qenë ajo që është propozu nga komandantët e zonave, kanë qenë  
7 anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm dhe ju ka prezantu më vonë  
8 anëtarëve tjerë të shtabit. Për atë në këtë takim është  
9 vendosë që unë të jem komandant i përgjithshëm me propozimin e  
10 komandantëve të zonave.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, problemi ishte që  
12 anëtarët e delegacionit nuk kanë qenë të përfshirë në  
13 përzgjedhjen tuaj, që nuk kanë qenë të pranishëm?

14 PË. Jo, për këtë aspekt, por vetë rrethanat të cilat ishin  
15 për këtë kohë nuk kam mujt ta shtrij funksionin tim si  
16 komandant i përgjithshëm ndoshta në aspekte më të gjena.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Më korrigjoni nëse e kam  
18 gabim, nëse e kam keqkuptuar unë, pra, po thoni ju në dëshminë  
19 tuaj që ju kërkoni miratimin e tyre, pëlqimin e tyre, pra, ju  
20 donit të merrnit miratimin e anëtarëve të delegacionit që nuk  
21 ishin të pranishëm në takimin ku u emëruat ju apo ku u caktuat  
22 ju?

23 PË. Jo, nuk po them këtë. S'e kam prit për këtë.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju lutem na e shpjegoni. Na  
25 e shpjegoni dhe një herë.

1 PË. Domethënë, pjesa e delegacionit ka qenë shumica pjesë e  
2 delegacionit e anëtarëve që kanë qenë anëtarë të Shtabit të  
3 Përgjithshëm kanë qenë në Rambuje. Kurse unë si komandant i  
4 zgjedhur kam qëndru në Abri, në Drenicë dhe nuk e kam -- për  
5 arsye të mia nuk e kam ushtru ndoshta, jo për pritjen e  
6 delegacionit.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në paragrafin 6 thuhet  
8 kështu dhe po ua lexoj dhe një herë fjalinë që ju i keni thënë  
9 Prokurorisë sipas këtij paragrafi të paktën se:

10 "Nuk mund t'i ushtronit funksionet tuaja si komandant i  
11 përgjithshëm deri në momentin që të kthehej delegacioni i  
12 Rambujesë ..."

13 Kështu thuhet në paragrafin 6. Prandaj po ju pyes sërish:  
14 Pse nuk mund t'i ushtroje funksionet si komandant i  
15 përgjithshëm deri në kthimin e delegacionit, sepse ju tani po  
16 thoni që keni pas arsyet tuaja, po nuk ia keni thënë këtë  
17 Prokurorisë javën e kaluar, nuk e keni thënë kështu?

18 PË. Po e them ma të përgjithshme. Sepse unë kur jam zgjedhë  
19 komandant i Drenicës, isha nga Drenica dhe kisha njoftime.  
20 Edhe prapë kam vazhdu që të jem në Drenicë, të jem afër  
21 ushtarëve dhe të jem afër njerëzve të cilët kisha vepru edhe  
22 më herët. Sa i përket në këtë aspekt e kam mendu.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, me fjalë të tjera,  
24 mosushtrimi i detyrave nuk kishte lidhje me faktin që nuk  
25 ishin të pranishëm anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm apo të

1 delegacionit, pra, kur jeni përzgjedhur ju si komandant i  
2 përgjithshëm, pra, s'kishte lidhje me këtë?

3 PË. E saktë.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Tani e kemi që  
5 qartë.

6 Shohim paragrafin 16 tani të Shënimit Përgatitor numër 1.  
7 Në këtë paragraf thuhet kështu, që ju i keni thënë Prokurorisë  
8 gjatë seancës përgatitore se komentet tuaja lidhur me  
9 incidentet e arrestimeve janë të paplota në gjuhën shqipe,  
10 ndërsa anglishtja që ju kanë treguar ka qenë e saktë. Dhe  
11 thuhet po ashtu këtu që ju jeni informuar për ushtarët e UÇK-  
12 së që ushtarët e UÇK-së janë marrë për t'ju marrë në pyetje  
13 dhe "këto kanë qenë probleme personale apo mosmarrëveshje mes  
14 vetë ushtarëve përfshirë sjelljet e papërshtatshme (si fakti  
15 që pinin në mbrëmje dhe shtinin me armë në ajër)."

16 A ju kujtohet, z. Selimi, që keni folur për ushtarë që  
17 gjuanin me armë në ajër bosh apo pinin shumë mbrëmjeve, ju  
18 kujtohet ta keni diskutuar këtë gjë me Prokurorinë?

19 PË. Po, e saktë.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Keni dijeni për raste, z.  
21 Selimi, kur të jenë arrestuar ushtarë të UÇK-së sepse kanë  
22 ndaluar apo keqtrajtuar civilë, pra, jo vetëm të jenë ndaluar,  
23 të jenë arrestuar se pinin shumë në mbrëmje apo gjuanin në  
24 ajër po të jenë arrestuar sepse kanë ndaluar civilë?

25 PË. Jo, nuk më kujtohet ndonjë rast.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju personalisht asnjëherë  
2 s'keni urdhëruar ju që të arrestohet ndonjë ushtar në zonën  
3 tuaj, në zonën e Drenicës sepse mund të ketë ndaluar,  
4 keqtrajtuar dhe rrëmbyer civilë?

5 PË. Jo, asnjëherë.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

7 Vazhdojmë në paragrafin 20 dhe pastaj pas këtij paragrafi  
8 do bëjmë pushimin e shkurtër.

9 Në këtë paragraf, është paragrafi 20 i Shënimit  
10 Përgatitor numër 1, keni diskutuar një dokument. Dhe bëhet  
11 fjalë për dokumentin që ka numrin e provës P00140. Dhe ju keni  
12 thënë pasi keni parë këtë dokument, keni thënë që "nuk e  
13 njihnit akronimin SHOND", S-H-O-N-D, "po ka mundësi të lidhet  
14 me arkivën e zonës (ç'ka do të thotë se dokumenti duhet të  
15 shkonte në Shtabin e Përgjithshëm, në arkivën e zonës dhe në  
16 Brigadën 111)."

17 Por ju i keni thënë Prokurorisë që ju nuk e keni ditur  
18 nëse i ka shkuar Shtabit të Përgjithshëm ky dokument "po  
19 supozohet që të shkonte tek ata".

20 Nuk më intereson dokumenti konkret, z. Selimi. Po e kam  
21 më në terma të përgjithshëm, nëse do të kishit një porosi, një  
22 dokument apo një kopje të një dokumenti për Shtabin e  
23 Përgjithshëm, praktikisht, në realitet si e çonit këtë  
24 dokument në Shtabin e Përgjithshëm?

25 PË. Ka qenë një Shaban Shala për çështje të informimit edhe

1 kontakte me shtabin. Në këtë aspekt, është që çu fizikisht ose  
2 gojarisht përmes telefonit.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Tani është  
4 momenti i përshtatshëm për pushimin.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë  
6 dhjetë minuta pushim, Dëshmitar. Mund të largoheni nga salla e  
7 gjyqit.

8 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë dhjetë  
10 minuta pushim.

11 --- Seanca ndërpritet në orën 15.28

12 --- Seanca rifillon në orën 15.39

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
14 silleni dëshmitarin në sallë.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të  
17 vazhdojmë më tej me pyetjet e Gjykatësve, z. Selimi.

18 Mund të vazhdoni, Gjykatësi Barthe.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

20 Z. Selimi, pyetjet e mia të radhës kanë të bëjnë me  
21 seancën përgatitore numër 2, ose më saktë me Shënimin  
22 Përgatitor numër 2. Do fillojmë me paragrafin 7 të këtij  
23 shënimi. Këtu në këtë paragraf thuhet që ju i keni thënë  
24 Prokurorisë gjatë seancës përgatitore që z. Rexhep Selimi  
25 kishte një bodigard që quhej Avdi Raci, ose Raçi. A ia keni



1 thënë Prokurorit të këtë, Dëshmitar?

2 PË. Ka qenë një shoqërues që e ka shoqëru, domethënë, Avdi  
3 Raci.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na e shpjegoni se  
5 përse kishte nevojë Rexhep Selimi të kishte në bodigard, një  
6 roje?

7 PË. Nuk është fjala që, për roje, por për sa herë që ka shku,  
8 ka shku bashkë me të. Në shumicën e rasteve fjala ka qenë më  
9 shumë për në Abri kur jemi taku, apo dikund tjetër, por është  
10 pyet atëherë për të, kam thanë po, që Avdi Raci ka qenë  
11 shumicën e kohës me të që, shoqërues i tij, jo si bodigard.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, ju përmendët dhe,  
13 përmendët përsëri këtë fjalën bodigard ose roje. Cili ishte  
14 qëllimi, cili ishte qëllimi i këtij personi? Pra, ky personi  
15 që e ka shoqëruar z. Selimi, ka pas si qëllim që ta ruante z.  
16 Selimi, domethënë Rexhep Selimi, e shoqëronte për ta ruajtur,  
17 për çfarë?

18 PË. Jo, nuk besoj që pa ruajtur, por e ka shoqëru si shok i  
19 afërt i tijna.

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Ka pasur një, besoj gabim,  
21 transkripti në rreshtin 25. Sepse kam përshtypjen që në  
22 versionin në transkript duhet të thuhet që "për pjesën e madhe  
23 të kohës ai nuk ka qenë bodigardi i tij".

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Kjo shpjegon  
25 keqkuptimin prej meje.

1 Pra, këtu nuk po flasim për bodigard, po flasim për një  
2 si me thënë, një shok, ose një asistent personal? Këtë po  
3 thoni?

4 PË. Besoj që ashtu. Jo si bodigard për me rujt nga afër, por  
5 si shoqërues i tijna.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Selimi, gjatë pyetjeve të  
7 Prokurorisë, ju përmendët që z. Thaçi ka pasur një bodigard.  
8 Të paktën kështu është përkthyer që ka pasur një bodigard.  
9 Pyetja ime është kjo, po z. Thaçi a ka pasur një bodigard apo  
10 ishte bëhej fjalë përsëri për një shok të z. Thaçi që e  
11 shoqëronte atë?

12 PË. Fjala është për pas luftës, e ka pas bodigard. Gjatë  
13 luftës z. Thaçi nuk, ka pas shoqërues të vetin. Pra, disa herë  
14 kur e kam pa ose një herë kur e kam pa, ka qenë me të. Por jo  
15 si bodigard, por si shoqërues i tij. Se në luftë s'ke pas  
16 arsye të kesh bodigard.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

18 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. U konsultova me z.  
20 Thaçi, thjesht z. Thaçi donte që të qartësonte se në çfarë  
21 periudhe kohe bëhej fjalë për këtë bodigardin. Ndërkohë që  
22 dëshmitari sapo e sqaroi periudhën e kohës. Faleminderit  
23 gjithsesi që më dhatë mundësinë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
25 Mund të vazhdoni, Gjykatës Barthe.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Këta persona që e kanë  
2 shoqëruar z. Rexhep Selimi dhe z. Thaçi, a kanë qenë të  
3 armatosur apo jo?  
4 PË. Po, kanë qenë të armatosur. Gjatë luftës kemi qenë të  
5 armatosur të gjithë.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po ju vetë, a keni pas  
7 ndonjë përcjellës, ndonjë person që ju përcillte. Nuk po e  
8 them, nuk po e quaj më bodigard, por një person që ju  
9 shoqëronte, ju e kishit?

10 PË. Në shumicave e rasteve kur kam lëviz, po, kam pas njerëz  
11 afër vete, krejt zonës ose në një vend të caktum, por një që  
12 më ka shoqëru shumë afër, po kam pas. Jo si bodigard, por si  
13 shok.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Me sa keni dijeni ju, a ka  
15 pasur komandantë të tjerë të zonave, si për shembull,  
16 komandant Remi, Drini, Haradinaj, komandant Rama, Buja,  
17 komandantët e tjerë, të gjithë kanë pasur persona që i kanë  
18 shoqëruar, me sa keni dijeni ju? Pra, persona që kanë qenë  
19 pranë tyre, kanë qëndruar me ta, që i kanë shoqëruar ata? Po  
20 këta të tjerët kanë pasur persona të tjerë shoqërues?

21 PË. Nuk e di për ta, por kur kanë lëviz prej zonës në zonë,  
22 se kur kemi pas një takim, normal që kanë ardh edhe me njerëz  
23 të tjerë.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Përderisa  
25 folëm për z. Rexhep Selimi dhe z. Thaçi, a e dini në qoftë se

1 dy të akuzuarit e tjerë, z. Veseli dhe z. Krasniqi kanë pasur  
2 bodigardë, ose persona që i kanë përcjellë, që i kanë  
3 shoqëruar ata?

4 PË. Jo, nuk e di.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Tani do të  
6 kaloj në një temë tjetër. Më konkretisht do t'i referohem  
7 paragrafit 33 të Shënimit Përgatitor numër 2. Në këtë paragraf  
8 të Shënimi Përgatitor ju diskutoni me Prokurorinë një provë  
9 materiale që është P00135, e keni diskutuar këtë çështje me  
10 Prokurorin gjatë seancës përgatitore. Nuk jam i interesuar për  
11 dokumentin, por jam i interesuar më tepër për informacionin që  
12 ju i keni dhënë Prokurorisë dhe që është shënjuar në  
13 paragrafin 33. Dhe ka të bëjë me një thirrje telefonike ose  
14 një komunikim me një person që quhet Ahmet Krasniqi.

15 Këtu thuhet që ju e keni thirrur në telefon këtë person  
16 sepse donit ta falënderonit që kishte dërguar oficerë të tillë  
17 si Kemal Shaqiri në zonën operative të Drenicës. A ju kujtohet  
18 ta keni diskutuar këtë me Prokurorin ose që ta keni përmendur  
19 këtë informacion gjatë seancës përgatitore, domethënë, këtë  
20 thirrje telefonike, ju kujtohet ta keni përmendur me  
21 Prokurorin, Dëshmitar?

22 PË. Po, e saktë. Në, thirrjen telefonike e ka bo z. Kemal  
23 Shaqiri edhe ma ka jep në telefon me bisedu. E kam falënderu,  
24 kjo ka qenë në Likovc, në kohën kur ka ardh.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ju kujtohet se kur ka

1 ndodhur kjo thirrje telefonike, kur e keni marrë në telefon z.

2 Krasniqi?

3 PË. Nuk e di saktë, por përmes telefonit të tijna, të z.

4 Shaqiri, edhe besoj që kohën kur ka ardh s'e di saktë.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Telefoni që është përdorur

6 nga z. Shaqiri ose prej jush, ishte telefon satelitor, ishte

7 telefon mobil apo ishte telefon tokësor?

8 PË. Telefoni i, ai ka folë më duket ka qenë telefon i, jo

9 satelitor, kur ma ka jap në telefon me fol. Por unë s'kam pas

10 një telefon të tillë. Unë kam përdor një telefon satelitor.

11 S'më kujtohet saktë, por besoj që me telefonin e tijna

12 domethënë, e ka pas, jo satelitor.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për t'u siguruar që është i

14 saktë procesverbali, në procesverbal thuhet që ju sapo thatë

15 që keni përdorur, ju keni përdorur një telefon satelitor. Pra,

16 a është e saktë që ju keni përdorur telefon satelitor në kohën

17 kur keni komunikuar përmes telefonit apo kur keni pasur

18 thirrje telefonike me z. Krasniqi?

19 PË. Jo, me z. Krasniqi një herë vetëm kam bisedu një minutë

20 ose dy, që e kam falënderu, edhe më tha z. Kemal Shaqiri.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Këtë e kuptova, z. Selimi.

22 Pyetjen e kisha paksa ndryshe. A kishit ju telefon satelitor?

23 Nuk të pyeta në qoftë se përdorët telefonin satelitor për të

24 komunikuar ose për të folur me z. Krasniqi. Pyetja ishte që, a

25 keni pasur telefon satelitor në kohën kur është bërë thirrja?

1 PË. Po, e saktë.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Është e qartë tani.

3 Megjithatë, juve nuk ju kujtohet në qoftë se z. Krasniqi ju  
4 dha një telefon fiks ose ju dha një telefon mobil, ose  
5 celular? Nuk ju kujtohet kjo, apo jo?

6 PË. Jo, z. Krasniqi s'më ka jep telefon.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Jo, e kam unë gabim, jua  
8 thashë unë gabim pyetjen, Dëshmitar. E kisha fjalën për z.  
9 Shaqiri, domethënë, a ju kujtohet në qoftë se z. Shaqiri ju ka  
10 dhënë një telefon celular ose telefon fiks për të komunikuar  
11 me Krasniqin?

12 PË. S'po më kujtohet saktë, por besoj që ka, z. Shaqiri në  
13 atë moment e ka pas një telefon të vogël, kur unë kam bisedu,  
14 kur ma, jep, me e falënderu.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Çfarë roli ka pasur z.  
16 Krasniqi kur keni biseduar me të? Kishte ndonjë funksion, rol  
17 zyrtar ai?

18 PË. Ka qenë si ministër i mbrojtjes në qeverinë e Bukoshit.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini se ku qëndronte ai  
20 në atë kohë?

21 PË. Jo, nuk e dija.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në intervistën që i keni  
23 dhënë Zërit, që është prova P01745, në versionin në anglisht  
24 është në faqen 14, nuk mendoj që është e nevojshme që të  
25 paraqitet në ekran artikulli. Megjithatë në artikull ju

1 përmendni që Kemal Shaqiri ishte oficer i FARK-ut që kishte  
2 dezertuar dhe ishte larguar në Shqipëri në shtator të vitit  
3 1998, pra një person i cili ishte larguar nga Kosova pa lejen  
4 tuaj. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

5 PË. Nuk e di sa është e saktë, por e di se në ofensivën e  
6 përgjithshme mbas ofensivës së shtatorit, e di se z. Shaqiri  
7 ka udhëtu për Shqipëri. Nuk ka qenë deri në fund të luftës.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A jeni në dijeni nëse z.  
9 Krasniqi, domethënë Ahmet Krasniqi, a jeni në dijeni që ai  
10 është vrarë në Tiranë në shtator të vitit 1998? Më saktë, më  
11 21 shtator?

12 PË. Kemi dëgju për, e dimë si rast që ka ndodh, por nuk e di  
13 ma shumë.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Me fjalë të tjera, përderisa  
15 ju përmendët shtatorin e 1998, si koha kur është larguar z.  
16 Shaqiri nga Kosova, dhe keni dëgjuar për vrasjen e z.  
17 Krasniqi, i takon që kjo thirrje telefonike ka ndodhur përpara  
18 shtatorit të vitit 1998, ose të paktën përpara 21 shtatorit të  
19 1998. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

20 PË. Po, shumë ma herët.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

22 Z. Selimi, do të vazhdojmë me një paragraf tjetër.  
23 Konkretisht paragrafin 42 të Shënimit Përgatitor numër 2. Në  
24 këtë paragraf flitet për shënimet ose procesverbalet e  
25 pretenduara të një takimi të ndodhur më datë 6 shkurt 1999.

1 Këtë dokument e keni parë disa herë gjatë dëshmisë tuaj. Dhe  
2 përsëri nuk mendoj që e nevojshme ta shikoni më. Pra, që të  
3 shikoni shënimet, procesverbalin, apo dokumentin që e keni  
4 parë disa herë.

5 Megjithatë, në paragrafin 42 të shënimit përgatitor  
6 thuhet se ju i keni thënë Prokurorisë në seancën përgatitore  
7 se keni pasur kritika lidhur me Sokol Bashotën dhe Jakup  
8 Krasniqin, dhe punës që është bërë asokohe, megjithëse sipas  
9 shënimit, nuk ju kujtohet që të keni thënë ndonjë gjë të kësaj  
10 natyre, që përfshihet ose pasqyrohet në dokument.

11 Pyetja ime është kjo: Në qoftë se kjo është e vërtetë,  
12 për çfarë ishin kritikët tuaja, çfarë kritikoni ju lidhur me  
13 këta persona?

14 PË. Në rastin e Bashotës, ka qenë si zëvendëskomandant për  
15 operacionet, dhe unë si komandant i zonës, asnjherë nuk kam  
16 pas një asistencë ose një diçka të tillë që me u mbështet në  
17 operacione ose në një, me plan operacional apo një betejë, dhe  
18 kjo ka qenë arsyeja që si shef i operacioneve ose si  
19 zëvendëskomandant i operacioneve, që kanë qenë kritika ndaj  
20 tijna.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po z. Jakup Krasniqi?

22 PË. Për Jakupin, z. Krasniqi, të gjithë e kemi pas një  
23 respekt jashtëzakonisht të madh edhe për veprimtarinë e tijna,  
24 por për çështjet ushtarake kam mendu që nuk është i  
25 përshtatshëm, që për çështjet operacionale dhe komanduese edhe



1 në terren kam mendu që në atë kohë që nuk është i  
2 përshtatshëm.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pse ka ndodhur kjo? Pse e  
4 keni menduar kështu, që ai nuk ishte personi i duhur për  
5 funksione operative dhe komanduese në atë kohë? Pse e keni  
6 pasur atë opinion?

7 PË. Për arsye që nuk kishim as takimet, as të nivelit të  
8 komandantëve që për sugjerime ose për plan operacional, apo  
9 për diçka të tillë.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini se çfarë roli apo  
11 funksioni ka pas z. Krasniqi në atë kohë, pra në kohën kur ka  
12 ndodhur takimi në shkurt të vitit 1999?

13 PË. Jo, por në vendimin kur e kam marrë ka qenë si  
14 zëvendëskomandant i Shtabit të Përgjithshëm.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

16 Tani do të kalojmë në paragrafin 76 e Shënimit Përgatitor  
17 numër 2.

18 Do i kërkoja Sekretares të seancës të na kalojë në seancë  
19 private për këtë pyetje, për mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe të  
20 tjerëve.

21 [Seancë private]

22 [Seancë private teksti i fshirë]

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4 [Seancë e hapur]

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

7 Z. Selimi, tani kam nja dy pyetje për atë që keni thënë  
8 më herët në dëshminë tuaj këtu. Kur ju bënë pyetje për dënimin  
9 e mëparshëm, nëse nuk e kam gabim, ju thatë që jeni dënuar për  
10 krime lufte në Kosovë, kinse të kryera në Likovc.

11 PË. Po, e saktë.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A keni qëndruar në burg?

13 PË. Po.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sa kohë keni qëndruar në  
15 burg për këtë, për këtë dënim?

16 PË. Afër gjashtë vite, kam qenë faktikisht i dënum prej tetë  
17 vite, edhe e kam mbajtur diku afër gjashtë vite, pesë a gjashtë  
18 muaj po më duket, nuk e di saktë. Edhe kam kry edhe gjithë  
19 procedurat të tjera.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kuptoj. Në paragrafin 78 të  
21 Shënimit Përgatitor numër 2, thuhet, po ua lexoj, thuhet:

22 "Edhe me informacionin që ka W04290 tani, ai ende nuk e  
23 di nëse ka pasur qendra ndalimi në zonën operative të  
24 Drenicës. Mund të jenë ndaluar persona në punktet në fjalë,  
25 por askush nuk është mbajtur i ndaluar, askush nuk është marrë

1 në pyetje apo është mbajtur i ndaluar në Likovc.”

2 Dje, në faqen 4 të transkriptit të djeshëm, ju thatë se  
3 nuk keni informata që personat të jenë arrestuar apo të jenë  
4 të mbajtur të ndaluar në Likovc. A ju kujtohet që e thatë këtë  
5 dje?

6 PË. Po, e saktë.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Unë dua t'ju pyes tani,  
8 atëherë si e shpjegoni ju që Gjykatat në Kosovë kanë marrë  
9 prova nga persona që pretendojnë se janë mbajtur të ndaluar  
10 dhe keqtrajtuar në Likovc në 1998 dhe 1999, veçanërisht në  
11 ish-stacione te policisë, dhe këtu përfshihet edhe ju? A na e  
12 shpjegoni dot këtë?

13 PË. Unë as atëherë, edhe gjykatës gjatë procesit gjyqësor,  
14 asnjëherë s'e kam pranuar që kjo ka qenë e vërtetë, mirëpo sipas  
15 dëshmisë së Dëshmitarit A, ai ka marrë vendim që i ka besu  
16 atij që ka qenë e vërtetë dhe jemi dënu. Mirëpo, edhe tash, po  
17 them, edhe, pse edhe unë jam dënu edhe e kam mbajtur dënimin,  
18 prapëseprapë e di, mendoj që ky person ka qenë i manipuluar dhe  
19 nuk ka qenë e vërtetë.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] I manipuluar prej kujt?

21 PË. Nuk e di prej kujt, por nuk, sipas mendimit tim dhe  
22 sipas, ajo gjë të cilën ai e ka pretenduar që i ka ndodhur, nuk ka  
23 qenë e vërtetë. Por megjithatë, besimin ia ka falë gjykatës,  
24 dhe që unë të dënohem dhe jam dënu bashkë me grupin tjetër.  
25 Edhe e kam respektuar dënimin.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj.

2 Vazhdojmë për temën e radhës, paragrafi 82 i Shënimit  
3 Përgatitor numër 2. Këtu flitet sa shpesh ju ka vizituar ju  
4 axha juaj, Rexhep Selimi, ose sa shpesh ka udhëtuar në zonën e  
5 Drenicës. Sipas këtij paragrafi, është paragrafi 82, ju i keni  
6 thënë Prokurorisë se z. Selimi ka qenë në mbledhjen ku u  
7 zgjodhët ju si komandant zone, dhe besoni se ka qenë i  
8 pranishëm dhe Sokol Bashota. Mua më intereson prania e z.  
9 Rexhep Selimi.

10 Do të doja të më thoni në çfarë cilësie ka qenë z. Rexhep  
11 Selimi në këtë mbledhje ku u zgjodhët ju komandant zone?  
12 PË. Nuk e di në çfarë cilësie, por ka qenë prezent në këtë  
13 takim.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të  
15 vendosë në ekran provën P01745-ET. Është edhe në shqip ky  
16 material. Është intervista që keni dhënë për gazetën Zëri.  
17 Qëllimi pse duam ta shohim këtë artikull është për t'ju  
18 rifreskuar kujtesën.

19 Ju lutem të shkojmë në faqen 14 të anglishtes. Nuk e di  
20 çfarë numri ka shqipja në fakt. Mbase mund ta gjejmë.

21 Shkoni më poshtë, ju lutem. Tek shqipja, më poshtë.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Mbase ju ndihmoj unë, ma merr  
23 mendja që anglishtja ka numrin e faqes 6D00-073 [Sipas  
24 përkthimit], dhe faqja korresponduese në shqip besojmë që  
25 është faqja SPOE00360478. Nëse nuk është kjo faqe, duhet të



1 jetë faqja tjetër.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Selimi, më thoni nëse nuk  
3 e gjeni në fakt pjesën përkatëse, që do të lexoj unë tek  
4 anglishtja. Mundohuni ta ndiqni tek shqipja. Paragrafi i  
5 tretë, në mes të faqes, duhet të jetë, kur thuhet:

6 "Pas punimeve të shumta për një periudhë kohore ..."

7 Është tek shqipja, e gjeni? "Pas punimeve..." është në  
8 fund fare tek paragrafi në shqip, "Pas një pune të gjatë...",  
9 besoj.

10 PË. Po.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Vazhdoj  
12 atëherë:

13 "Pas një pune të gjatë në verë të 1998, në Plluzhinë në  
14 lagjen e Nurakëve u mbledhën të gjithë përgjegjësit e pikave,  
15 apo komandantët e njësiveve për të zgjedhur komandantin e  
16 zonës operative të Drenicës. Aty ishin të pranishëm Rexhep  
17 Selimi, përfaqësuesi SHP-së, Shtabit të Përgjithshëm, pra, të  
18 UÇK-së", më pas përmenden dhe persona të tjerë që "kanë qenë  
19 po ashtu të pranishëm atje".

20 Pyetja ime është kjo: Axha juaj, Rexhep Selimi, a ka qenë  
21 aty si përfaqësues i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së?

22 PË. E para, nuk është axha, por është djali i axhës, Rexhep  
23 Selimi.

24 Edhe, e dyta, po unë kam thënë në këtë intervistë se ka  
25 qenë si përfaqësues i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, është

1 e saktë. Por, kjo është dit ma vonë, pozicionet e tyne janë  
2 dit ma vonë në Shtabin e Përgjithshëm.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për procesverbal, se e kam  
4 pak të vështirë ta kuptoj unë. Domethënë, z. Rexhep Selimi  
5 është djali i axhës, është kushëriri juaj? Për procesverbal,  
6 jo axha juaj?

7 PË. E saktë.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Shih paragrafin, ju lutem  
9 paragrafin sipas paragrafit që lexuam, pra, ky paragrafi që  
10 thotë:

11 "Pra, riorganizimi filloi nga Drenicë që ishte një  
12 nënzonë operative deri në atë kohë ..."

13 E gjete tek shqipja? Paragrafi më sipër.

14 PË. Po, e saktë.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, fjalia e tretë, apo e  
16 katërt, nuk jam e sigurt, thuhet:

17 "Nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së për formimin dhe  
18 organizimin e njësiteve operative gjegjësisht zonave ishin  
19 angazhuar Rexhep Selimi ..."

20 E gjetët?

21 "... ishin angazhuar Rexhep Selimi ..."

22 PË. Po, e saktë.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Fjalia është kështu, pra:

24 "Inspektori i përgjithshëm, në Shtabin e Përgjithshëm të  
25 UÇK-së. Pra, nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së për formimin

1 dhe organizimin e njësive operative, gjegjësisht zonave, ishin  
2 angazhuar Rexhep Selimi, inspektori i përgjithshëm”.

3 Pyetja ime është kjo: Z. Rexhep Selimi a ka qenë në atë  
4 kohë inspektor i përgjithshëm kur mori pjesë në takim, a ka  
5 pas, apo ka pas ndonjë post tjetër?

6 PË. Nuk besoj që ka pas asnjë post dhe në atë kohë s’e kam  
7 dit që ka qenë anëtar Shtabi të Përgjithshëm. Mirëpo në ka  
8 qenë në takim edhe është, iu prezantu, anëtarët e Shtabit të  
9 Përgjithshëm përmes vetë z. Selimi, kurse sa i përket si  
10 gjeneral, inspektor ose inspektor i përgjithshëm, kjo, këtë  
11 titull ma vonë është marrë. Dhe unë iu kam referu të asaj çka  
12 pozitën të cilën e ka pas në shtab, si anëtar i Shtabit të  
13 Përgjithshëm, por jo për në kohën kur ne s’ishim të themelum.  
14 Ne ishim në pika.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Shohim paragrafin e tretë  
16 edhe njëherë, ju lutem në këtë faqe. Ky paragrafi:

17 “Pas një pune të gjatë në verë të 1998 ...”

18 Po përpigem të gjej një fjali ku thuhet që:

19 “Rexhep Selimi ka thënë që Shtabi i Përgjithshëm i  
20 UÇK-së ...”

21 E shihni te shqipja?

22 “Rexhep Selimi mori përgjegjësinë se ai cilët do të  
23 zgjedhet”, e gjetët tek shqipja?

24 PË. Po, po. Saktë.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Është fjalia e parë në këtë

1 faqe.

2 PË. Po, po. E shoh.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në anglisht të paktën thotë:

4 "Rexhep Selimi ka thënë që Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së  
5 do të miratonte cilindo që do të zgjidhej komandant nga ky  
6 takim."

7 Nëse nuk e kam gabim, ju thatë që zgjedhja juaj, caktimi  
8 juaj, si doni që ta quajmë, në fakt është aprovuar më vonë nga  
9 Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, saktë?

10 PË. Po, e saktë.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, është e vërtetë pra, që  
12 z. Selimi ka thënë që Shtabi i Përgjithshëm takoi cilindo që  
13 do të zgjidhet komandant nga ky takim. Është kjo e saktë?

14 PË. Është e saktë që z. Selimi t'ia dërgojë propozimet që ne,  
15 i kanë pas komandantët e pikave për mu dhe i ka dërgu në Shtab  
16 të Përgjithshëm, dhe nuk e di.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

18 Tema e fundit për sot, lidhet me paragrafin 89 të  
19 Shënimit Përgatitor numër 2, kjo është një temë që është  
20 diskutuar gjatë e gjerë në këtë sallë gjyqi, pothuajse nga të  
21 gjitha palët. Bëhet fjalë për takimin që keni pasur, mbase nuk  
22 jam i sigurt, kjo varet nga përgjigjja juaj, me personat ndër  
23 të tjerë me Agim Çekun, Hashim Thaçin, dhe Kadri Veselin, ndër  
24 të tjera. Bëhet fjalë për operacionin Shigjeta. Takimi me sa  
25 kuptojmë është mbajtur në zonën e Nerodimës.

1 A ju kujtohet ky takim dhe diskutimet që janë bërë në  
2 këtë sallë gjyqi lidhur me këtë takim?

3 PË. Po.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në paragrafin 89 të Shënimit  
5 Përgatitor numër 2 thuhet kështu, si në vijim, pas aprovimit  
6 të planit për operacionin, ju thatë pasi aprovuat, pasi e  
7 nënshkruat operacionin, u takuat me tri persona, me tre  
8 personat që unë përmenda, z. Çeku, z. Thaçi dhe z. Veseli. Dhe  
9 mua më intereson të mësoj prej jush çfarë pozite kishte  
10 fillimisht z. Thaçi në atë kohë, në atë takim, nëse kishte  
11 ndonjë pozitë? Ishte kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të  
12 Kosovës në ato momente apo jo?

13 PË. Në ato momente nuk besoj që, ka qenë si mandatar për  
14 formimin e qeverisë.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në faqen 51 të transkriptit  
16 të djeshëm, ju thatë që z. Thaçi priste persona dhe  
17 delegacione me qëllim që të formonte qeverinë e përkohshme të  
18 Kosovës në atë kohë. Pra, në dëshminë tuaj po thoni që nuk  
19 mendoni ju që në atë kohë ka qenë kryeministër i qeverisë së  
20 përkohshme të Kosovës, por ndërkohë ishte kthyer nga Rambujeja  
21 dhe kishte mandatin që ta formonte qeverinë e përkohshme të  
22 Kosovës, pra kjo është dëshmia juaj që nuk ishte ende  
23 kryeministër, por kishte mandatin?

24 PË. Unë, faktikisht, nuk, në këtë periudhë pas kthimit të  
25 delegacionit, ka fillu me u formu qeverinë e përkohshme. Edhe

1 detyra tash unë e kam paramendu se si mandatar ose ende s'e,  
2 sa i di unë, s'e di procedurat qysh shkon, a duhet që qeveria  
3 ta mandatojë, ose ta asi, ta caktojë rolin e kryeministrit në  
4 këtë aspekt, por nuk e di. Domethënë në këtë kohë ka qenë që,  
5 mandatar i zgjedhur prej gjithë delegacionit që ta formojë  
6 qeverinë e përkohshme.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Misetic, ka diçka? Apo të  
8 vazhdoj?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Thaçi kërkon të sqarohet  
10 periudha kohore, por do ta bëj unë këtë pyetje kur të bëj  
11 pyetjet plotësuese të miat.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sigurisht, po e pyesim, nuk  
13 është problem.

14 Flasim, është e qartë, bëhet, është e qartë për kur bëhet  
15 fjalë. Domethënë, bëhet fjalë kur është kthyer delegacioni nga  
16 Rambujeja, kështu e kam kuptuar unë.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Meqë më pyetët, z. Thaçi kërkon  
18 dhe thekson që të themi që qeveria e përkohshme nuk është  
19 formuar deri në prill dhe po diskutohet për një takim në fund  
20 të marsit. Kjo është pozita e tij.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Këtë dua të zbuloj edhe unë  
22 në fakt. Faleminderit për ndërhyrjen.

23 Dua t'i bëj një pyetje Dëshmitarit.

24 I AKUZUARI THAÇI: [Mikrofoni çaktivizuar].

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Selimi, e dëgjuat çfarë

1 tha z. Thaçi? Bëhet fjalë për një takim, pra supozohet që  
2 takimi ka qenë në fund të marsit.

3 Z. Thaçi kështu? Në fund të marsit? Z. Misetic.

4 I AKUZUARI THAÇI: [Mikrofoni çaktivizuar].

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic,  
6 z. Thaçi nuk mund të japë dëshmi lidhur me këtë.

7 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, qëndrimi ynë është që ky takim  
9 është mbajtur në fund të marsit.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirë atëherë.

11 Z. Selimi e dëgjuat këtë që sapo u tha, pra, që takimi në  
12 fjalë supozohet që ka qenë në fund të marsit? Do të ndryshoni  
13 gjë në dëshminë tuaj lidhur me këtë që sapo thatë pak më  
14 përpara? Flasim gjithmonë për rolin e z. Thaçi. Cili ka qenë  
15 roli i z. Thaçi në atë kohë?

16 PË. Delegacionin nuk e di kur është kthy, dhe e di që ka qenë  
17 takimi në formimin e sipër të caktimeve të njerëzve nëpër  
18 pozita. Kur është formu qeveria dhe kur është [E  
19 pakuptueshme], nuk e di.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

21 Faleminderit, do vazhdojmë nesër. Më falni, do vazhdojmë  
22 sot edhe tri-katër minuta. Kam edhe dy pyetje.

23 Z. Selimi, kam dhe disa pyetje. Pyetja e radhës lidhet me  
24 atë që keni thënë në faqe 83 deri në 84 të transkriptit të  
25 djeshëm. Kur ju bëri pyetje z. Misetic, Avokati i z. Thaçi, ai

1 ju pyeti nëse mund të konfirmonit ju që Qeveria e Përkohshme e  
2 Kosovës nuk kishte asnjë rol, asnjë përfshirje në emërimin  
3 tuaj si zëvendëskomandant të TMK-së. Dhe ju thatë që "po, e  
4 vërtetë", nuk ka pas asnjë rol. Ju kujtohet kjo?

5 PË. Po, është e saktë. Unë jam emëru -- më fal.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Tani meqë nuk ju është bërë  
7 kjo pyetje, ju nga e dini këtë? Nga e dini ju që qeveria e  
8 përkohshme e Kosovës nuk ka pasur asnjë rol apo asnjë lloj  
9 përfshirje në emërimin tuaj, ua ka thënë dikush konkretisht  
10 këtë?

11 PË. Jo, por unë kam qenë në vend në takime kur ne kemi, dhe  
12 atëherë ka qenë administrata e UNMIK-ut dhe përfaqësues, ose  
13 si ministër për forcën e sigurisë ka qenë një anglez. Edhe  
14 emërimet janë bo nga UNMIK-u.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] UNMIK-u, si doli në  
16 përfundim që të zgjidhte emrin tuaj? A ju rekomandoi ndonjë  
17 person, a ju propozoi ndonjë person, a aplikuat vetë për këtë  
18 vend pune te UNMIK-u?

19 PË. Jo, ne ishim në pozicione të ndryshme si komandantët e  
20 zonave, Agim Çeku si komandant hala gjatë transformimit si  
21 komandant i UÇK-së, unë si komandant garde. Dhe në,  
22 paraprakisht ka shku krejt në këtë sistem. Edhe në nivel të  
23 emërimeve.

24 Si komandant garde është emëru Nuredin Lushtaku, kurse  
25 unë si zëvendëskomandant i Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe



1 komandant Agim Çeku. Gjithë kjo ka qenë një procedurë e  
2 UNMIK-ut.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

4 Pyetja e fundit për sot. Ju bënë disa herë pyetje, ju  
5 bëri disa herë pyetje Avokati i z. Thaçi, po mbështetem në  
6 transkriptin e djeshëm, ai ju pyeti nëse ju në cilësinë tuaj  
7 si komandant i zonës operative mund ta arrestonit anëtarë të  
8 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së? Dhe pasi ju bëri pyetjen,  
9 ju tregoi dokumentin që është pranuar tani si provë gjyqësore,  
10 me numër 1D00247. Ju kujtohet kjo pyetje?

11 PË. Po.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju thatë në faqen 91 si në  
13 vijim. Kjo është në transkriptin e djeshëm.

14 "Jo vetëm kundër këtyre tri personave në veçanti apo  
15 kujtdo tjetër, por komandanti i zonës kishe përgjegjësi të  
16 plota dhe autoritetin të ndërmerre masa, dhe komandanti i  
17 zonës merrte përgjegjësinë për këtë, me komandantët e  
18 brigadave në këtë kohë.

19 "Nëse një komandant operativ mund të ndikohej apo jo,  
20 është çështje tjetër. Sidoqoftë komandanti i zonës e kishte  
21 autoritetin, të paktën zona jonë, zona e Drenicës."

22 Pyetja ime është kjo tani: "Po thoni ju në dëshminë tuaj  
23 që ju si komandant i zonës operative mund ta arrestonit  
24 cilindo në zonën tuaj operative, përfshirë këtu anëtarët e  
25 Shtabit të Përgjithshëm? Është kjo dëshmia juaj?"

1 PË. Unë si komandant zone, kam pas autoritetin edhe  
2 përgjegjësinë për zonën operative të Drenicës. Dhe çdo gjë  
3 rreth organizimit, apo edhe luftimeve dhe të gjitha  
4 operacioneve të tjera, unë kam pas përgjegjësinë si komandant  
5 zone.

6 Sa i përket arrestimeve, nuk do të thotë që, unë kam tha  
7 dhe po them edhe tash që asnjherë nuk e di që kam lëshu një  
8 fletë-arrest diku, qoftë në zonë apo dhe anëtarëve të  
9 Shtabit të Përgjithshëm. Nuk është e vërtetë.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj që nuk e keni bërë,  
11 por pyetja ime është: E kishit autoritetin, kompetencat ta  
12 bënit nëse do të donit? Dhe nëse po, mbi ç'baza e kishit ju  
13 këtë kompetencë, kishte ndonjë dispozitë, kishte ndonjë  
14 rregullore që ju autorizonte ju të arrestonit anëtarë të  
15 Shtabit të Përgjithshëm në cilësinë tuaj si komandant i zonës  
16 operative, në zonën tuaj operative?

17 PË. Jo, nuk e kam pas asnjë kompetencë, asnjë udhëzim, asnjë  
18 rregullore.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Selimi. Unë  
20 s'kam më pyetje për ju. Faleminderit për durimin tuaj.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Selimi,  
22 për sot përfunduat. Faleminderit që ishit këtu, do shihemi  
23 sërish në orën 9.00 dhe shpresojmë që nesër ta përfundojmë  
24 dëshminë tuaj.

25 Faleminderit dhe ju, z. Qerkini.

1 Mund të largoheni tani nga salla.

2 DËSHMITARI: Faleminderit.

3 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

5 --- Seanca mbyllet në orën 16.38

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25